



**Mesazh urimi i SHSHPPFA
me rastin e 110 - vjetorit të
krijimit të Forcave të Armatosura**



» faqe 3

110 - VJETORI I FA-së 300 ARTISTË TË BANDAVE USHTARAKE TË VENDEVE TË NATO-S, KONCERT BAMIRËSIE PËR UKRAINËN, NË TIRANË



» faqe 3

**Vizita e anijes
britanike "RFA
MOUNTS BAY" në radë,
në Gjirin e Durrësit**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, anija britanike "RFA MOUNTS BAY" vizitoi gjirin e Durrësit. Kjo anije është një anije ndihmuese e Forcës Detare Britanike, e cila...

» faqe 5



**Baza ajrore e Farkës,
55 vite fluturime
humanitare,
sakrificë, përgjegjësi**

Baza ajrore e Farkës është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1967. Zanafilla e kësaj baze është në vitin 1956, kur pilotë e teknikë shqiptarë u dërguan për t'ju trajnuar në ish-Bashkimin Sovjetik në Rusi. Ndërsa në vitin 1957 u krijua njësi e parë e transportit ushtarak nr.5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa aeroplanë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandanti i njësisë...

» faqe 7



110 - vjetori i FA-së, mbi 300 artistë të bandave ushtarake të vendeve të NATO-s, koncert bamirësie për Ukrainën, në Tiranë

110 -vjetori i Pavarësisë, që përkon njëherësh edhe me 110-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, u kremtua me një seri aktivitesh në Tiranë dhe në disa rrethe të ndryshme të vendit.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë organizuan javën festive, me evente që u shtrinë në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe kulmuan me koncertin madhështor “110 vjet Forca të Armatosura - Së bashku për Paqen”, në Pallatin e Kongreseve.

Në këtë tur performuan mbi 300 artistë nga Orkestra Sinfonike e FA-së, Kori i FA-së, Banda e Ushtrisë shqiptare dhe Bandat e ushtrive të Kosovës dhe vendeve të NATO-s nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Franca, Italia, Greqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Sllovenia.

Kjo është hera e parë që një event i këtij dimension zhvillohet në Shqipëri.

Përmes këtij event, me moton “110 - vjet Pavarësi, 110 - vjet Forca të Armatosura - Së bashku për Paqen”, u dhanë mesazhe të forta solidariteti ndaj popullit ukrainas që po përballët prej 24 shkurtit me agresionin rus, por edhe mesazhe paqeje dhe sigurie për të gjithë botën.

Të pranishëm në këtë koncert madhështor ishin kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”



Peleshi, ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim dhe ambasadorë të vendeve të NATO-s dhe BE-së në Shqipëri, atashë ushtarakë, etj.

“Emocionues prezantimi i parë pas dekadash i Orkestrës Simfonike dhe Korit të Forcave të Armatosura”, - u shpreh kryeministri Edi Rama.

Është hera e parë që një event i këtij dimensionit zhvillohet në Shqipëri.

Të ardhurat e realizuara nga biletat do të shkojnë në mbështetje të familjeve me fëmijë të lënduar nga lufta në Ukrainë.

Risi tjetër e këtij eventi ishte dhe botimi i revistës “Mbrotjtja” pas shumë vitesh. Ky organ i Ministrisë së Mbrotjtjes, ku pasqyrohet aktiviteti i Forcave të Armatosura, do të jetë sërish në duart e lexuesit ushtarak dhe jo vetëm.

Ministri i Mbrotjtjes, z. Niko

Peleshi, në fund të aktivitetit do të falënderonte performuesit: “Të gjithë u mrekulluan me këtë shfaqje të mahnitshme, ishte unike në llojin e saj”.

Në këtë moment shumë të veçantë për Shqipërinë, në 110-vjetorin e Pavarësisë dhe krijimit të Forcave të Armatosura, disa mesazhe shkojnë përtej Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe paqen, që tashmë janë tronditur, për shkak të agresionit rus kundër Ukrainës.

Të gjithë jemi të shqetësuar për sigurinë dhe kjo është arsyeja, pse kemi ftuar shumë nga vendet anëtare të NATO-s, gjithashtu dhe vëllezërit tanë kosovarë, për të festuar, por dhe për të dhënë mesazhe paqeje.

Në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi, ministri i Mbrotjtjes, Niko Peleshi, shpërndau certifikata vlerësimi për bandat pjesëmarrëse.



Mesazh urimi i SHSHHPFA me rastin e 110 - vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura

Të nderuar ushtarakë dhe civilë të Forcave të Armatosura!
Si shef i Shtabit të Përgjithshëm, kam nderin dhe kënaqësinë t’ju përshëndes dhe t’ju uroj për përvjetorin e 110-të të krijimit të Forcave tona të Armatosura! Më 4 dhjetor 1912, patriotët dhe baballarët e kombit, ata që themeluan shtetin e parë shqiptar, krijuan edhe Forcat e Armatosura të këtij shteti.

Historia e Forcave tona të Armatosura, në këtë rrugëtim të gjatë mbi njëshekullor, është shkruar me punë, vetëmohim dhe sakrificë të jashtëzakonshme, një angazhim që sot, në këtë ditë të shënuar, ndjejmë krenari me histori suksesh, me përballje vështirësish dhe sfidash, me angazhime dhe kontribute të ndjeshme e të prekshme brenda vendit, por edhe sfidues në misionet e Aleancës dhe në çdo pikë të nxehtë të globit, ku jemi kërkuar.

Shërbimi me devotshmëri, besnikëri dhe përkushtim ndaj Shqipërisë ka qenë kryefjala e të gjithë gjeneratave që kanë qenë pjesë e forcës ushtarake të vendit tonë.

Angazhimi dhe kontributi i palodhur e fisnik ndër vite, për komunitetin dhe jetën e njerëzve të thjeshtë në situata emergjence, në kohë të vështira në fatkeqësi dhe nevojë, në ndihmë dhe në shpëtim jetësh njerëzore, i ka bërë Forcat tona të Armatosura dhe gjithë njerëzit tanë në uniformë, të dashur, të respektuar dhe shpresë në popull dhe komunitet.

Forcat e Armatosura i kanë dhënë zë dhe i japin nder e respekt sot



Shqipërisë në tre kontinente të botës, me ushtarakët e saj, që shërbejnë me dinjitet dhe sakrificë në vijën e parë të frontit të Aleancës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtar, në Letoni, Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Sudan e Irak.

Në këtë ditë solemne, vetëdija ime përcjell homazhin më të ndjerë të përljes ndaj të gjithë ushtarakëve

tanë, që me vetëmohim kanë bërë edhe sakrificën sublime në shërbim të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit dhe mesazhin më të thellë të mirënjohjes ndaj gjithë gjeneratave të ushtarakëve që kanë ndërtuar, zhvilluar, kontribuar dhe shërbyer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.


Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura!

Ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura më të motivuara, më të konsoliduara, më të afta dhe më të gatshme për kryerjen e misionit dhe detyrave të tyre fisnike, në shërbim të popullit tonë dhe përmbushjes së detyrimeve euroatlantike të Shqipërisë.

Statusi i lartë i fituar me kontribute dhe meritë, vëmendja dhe kujdesi i shtuar i autoriteteve kombëtare dhe mbështetja e veçantë e aleatëve tanë, janë siguria për zhvillime, modernizime dhe përmirësime të ndjeshme dhe të rëndësishme. Kjo na jep forcë dhe fuqi në kryerjen e misioneve dhe detyrave të së ardhmes, që po bëhen gjithmonë e më të shumta, më komplekse dhe sfiduese në kohët e vështira që po jetojmë, dhe ne duhet dhe do të jemi gjithmonë ku na kërkon dhe dërgon Shqipëria, në çdo skaj të vendit, në çdo pikë të globit! Ky është detyrimi ynë. Kjo është motoja jonë.

Unë jam besimplotë, se vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë në uniformë të Forcave tona të Armatosura, me profesionalizmin dhe patriotizmin, me përkushtimin dhe dedikimin e tyre epik, janë garancia e patundshme për kryerjen dhe plotësimin me sukses të çdo përgjegjësie, detyrimi dhe angazhimi në emër të Shqipërisë, ndaj qytetarëve shqiptarë dhe ndaj vlerave të Aleancës Euroatlantike.

Me mirënjohjen dhe nderimin më të thellë për shërbimin, vetëmohimin dhe përkushtimin tuaj dinjitoz, ju uroj gëzuar përvjetorin e 110-të të Forcave tona të Armatosura!



SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji, pret zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të NJ, gjeneralmajor Michael Wickman

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, pret në takim zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, njëkohësisht shef i Shtabit të USAEU-AF, gjeneralmajor Michael Wickman. Në fokus të bisedimeve ishte bashkëpunimi i mëtejshëm dhe stërvitjet e përbashkëta me ushtrinë amerikane, ndihma e madhe e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, si dhe përgatitjet mbi stërvitjet "Defender Europe-23".

Gjeneralmajor Wickman u njoh me projektet e përmirësimit të kapaciteteve operationale të FARSH-së.

Nga ana e tij, gjeneral brigade Arben Kingji shprehu mirënjohjen për SHBA-të për asistencën në këtë proces, si dhe mbështetjen e jashtëzakonshme në fusha të tjera të bashkëpunimit ushtarak.




SHSHP të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim komandantin e FD të Rumanisë, nënadmiral Mihai Panait

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti paradite në një takim kortezie komandantin e Forcave Detare të Rumanisë nënadmiral Mihai Panait.

Gjeneral brigade Kingji, në fjalën e tij gjatë takimit, e konsideroi shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ushtarak dypalësh midis dy vendeve në fushën e arsimit, trajnimit dhe stërvitjeve, por edhe atë në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta me NATO-n. "...Si vende anëtare të NATO-s, ne ndajmë të njëjtat sfida sigurie dhe forcat e armatosura të të dy vendeve tona po kontribuojnë në operatione të ndryshme në rajon e më gjerë", - theksoi ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

Më tej, gjatë takimit, gjeneral brigade Kingji shprehu gjithashtu mbështetjen e tij për të rritur më tej këtë bashkëpunim, sidomos për studentët dhe oficerët e detarisë në kurset që ofron Akademia e Detarisë së Rumanisë, por edhe duke vlerësuar fusha dhe mundësi të reja me interes të përbashkët. Nga ana e nënadmiral Panait u vlerësua bashkëpunimi që ekziston midis forcave detare të dy vendeve, por njëkohësisht edhe roli i Shqipërisë në rajon dhe më gjerë, duke kontribuar në misione dhe operatione të ndryshme.



Në përfundim të takimit të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim për thellimin e bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe arsimit

ushtarak, kryesisht në fushën e detarisë, HUMINT, si dhe angazhimeve të përbashkëta në operationet dhe stërvitjet në kuadër të Aleancës.

KTHOSH, vizitë në Vaun e Dejës

Në vijim të programit mësimor për vitin akademik 2022-2023 kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilluan vizitë njohëse në batalionin e parë të këmbësorisë së Forcës Tokësore, Vau i Dejës, Shkodër. Kjo vizitë u zhvillua si pjesë e programit të Departamentit të Operacioneve Ushtarake me qëllim njohjen e kursantëve me strukturat e Forcave tona të Armatosura, duke realizuar një ndërthurje midis anës teorike dhe asaj praktike. Staf i akademik dhe kursantët u mirëpritën nga nënkolonel Ali Mali, i cili, pasi i falënderoi për vizitën, evidentoi rëndësinë e këtij kursi për karrierën ushtarake, por edhe në rritjen e nivelit profesional për përbushjen në praktikë të detyrave nga oficerët me gradën "major" në të ardhmen. Më pas në brifingun e prezantuar, kursantët u njohën në veçanti me kontributin që jep ky batalion në operationet brenda dhe jashtë vendit. Kursantët treguan mjaft interes dhe drejtuan pyetje mbi emergjencat civile, punën që bëhet për rritjen e nivelit të operacionalitetit, modernizimit dhe përmirësimin e infrastrukturës. Në përfundim kursantët vizituan ambientet e kësaj njësie, ku panë nga afër infrastrukturën, pajisjet, masat për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.





Komandanti i Forcave Detare të Republikës së Rumanisë zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Detare

Në zbatim të planit të bashkëpunimit ushtarak me Republikën e Rumanisë, komandanti i Forcës Detare të Rumanisë, kundëradmiral Mihai Panait zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte rritja e bashkëpunimit dypalësh ushtarak midis forcave detare të dy vendeve dhe vlerësimi i mundësive për shtimin e bashkëpunimit të mëtejshëm në fusha me interes të përbashkët, si trajnime dhe stërvitje.

Kundëradmiral Panait dhe ekipi i tij zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, i cili u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra.

Gjatë takimit u diskutua ecuria e bashkëpunimit të deritanishëm midis dy forcave, si ai dypalësh, ashtu dhe në kuadër të Aleancës. Ushtarakët e dy vendeve vlerësuan vizitat portuale të anijeve rumune në vendin tonë dhe shkëm-

bimin e përvojës dypalëshe.

Në vijim të vizitës në Forcën Detare, kundëradmiral Mihai Panait zhvilloi një vizitë në ambientet e QNOD (Qendra e Vëzhgimit Detar), në të cilën u njoh me strukturën dhe organizimin e saj.

Kundëradmiral Panait, u prit në një vizitë kortezie dhe nga shefi Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, gjithashtu zhvilloi një vizitë në Akademinë e Forcave të Armatosura, gjatë së cilës u diskutua për krijimin e urave lidhëse midis AFA-së dhe Akademisë së Forcave të Armatosura të Rumanisë.

Ndërsa vlerësoi nivelin e detarëve tanë, kundëradmiral Mihai Panait falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen e treguar gjatë vizitës së tij tre ditore në Shqipëri.

Vizita e ekipit të nënoficerëve të SHNO (KDS), FSK, në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN/ANO), në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Shkollës së Nënoficerëve të KDS-së, FSK dhe QAPN-së, AFA, u zhvillua një vizitë njohëse nga ekipi prej 5 nënoficerësh i kësaj shkolle, i kryesuar nga Rreshter Major Atnan Qaili zëvendëskomandant i SHNO të KDS.



Vizita e anijes britanike "RFA MOUNTS BAY" në radë, në Gjirin e Durrësit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, anija britanike "RFA MOUNTS BAY" vizitoi gjirin e Durrësit.

Kjo anije është një anije ndihmuese e Forcës Detare Britanike, e cila shërben për operacionet e zbarkimit të mjeteve amfibe.

Nga ana e Forcës Detare Shqiptare u morën të gjitha masat e nevojshme për pritjen e kësaj anijeje dhe koordinimin e të gjithë aktivitetit të saj në vendin tonë. Për këtë qëllim Forca Detare angazhoi dy anije, anijen P-133 "LISSUS" dhe anijen P-04 "SEMANI" të cilat realizuan pritjen, shoqërimin e anijes për në vendin e qëndrimit në spirancë, transportin e personelit VIP si edhe personelit ushtarak, të cilët kryen vizita në anijen Britanike.

Kjo vizitë ofron një mundësi të shkëlqyer për të zhvilluar më tej lidhjet e forta midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, veçanërisht këtë vit që shënon 100-vjetorin e marrëdhënieve midis dy vendeve.



Vizitë mësimore e Kursit të 10-të të Kryekapterit në Kosovë

Në zbatim të programit mësimor të Kursit të Kryekapterit, i cili zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN), instruktorët dhe kursantët e këtij kursi zhvilluan një vizitë njohëse në Komandën e Forcës Tokësore të Forcës Sigurisë së Kosovës (FSK). Ata shkëmbyen eksperiencat e tyre dhe shfaqën gatishmërinë e bashkëpunimeve të mëtejshme.



Përfundon kursi 51 i Avancuar i Nënoficerit në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 51 të Avancuar të Nënoficerit.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Artan Bufi, atasheu ushtarak i Kosovës, nënkolonel Enver Hoti, komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, kolonel Ardian Lilo, nënoficeri i SHSH-PFA, nënoficeri i AFA-së, stafi i Komandantit, personel nga Dega e Administratës, Arsimimit dhe Kurseve mësimore.



Kompania EOD e Komandës Mbështetëse, një kapacitet mbështetës për eliminimin e rreziqeve nga municionet dhe eksplozivët

Shërbimi i asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve (EOD) është një kapacitet kombëtar mbështetës, që redukton dhe eliminon rrezikun që vjen nga municionet dhe eksplozivët që kërcënojnë personelin, instalimet ushtarake, popullsinë e pronën, si brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Qëllimi është krijimi i Qendrës së Ekselencës për EOD dhe Armatim-Municionin për të gjithë rajonin, nëpërmjet zhvillimit të kurseve të të gjitha niveleve, me ndihmën dhe bashkëpunimin e partnerëve tanë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kontingjente të EOD-së të Komandës Mbështetëse, prej vitesh kanë dhënë kontribut në misione të ndryshme ndërkombëtare dhe aktualisht janë pjesë e misionit të NATO-s “Enhanced Forward Presence” në Letoni. (NATO enhanced Forward Presence Battle Group Latvia).



Ndërtohet ura e re tip “bailey” në fshatin Kabash, Bashkia Pukë

Specialistët e Kompanisë së Urave, të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip “bailey”, me gjatësi 30 m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 tonë. Kjo urë ka një rëndësi të veçantë, pasi është vijimi i rrugës prej 6 km, rrugë e hapur nga Bashkia dhe mundëson lidhjen e fshatit Kabash.

Ura i vjen në ndihmë 500 banorëve në fshatrat Kabash, Buhot, Meçe. Kjo urë gjithashtu bën lidhjen e kishës historike e njohur si Abacia e Shën Palit, objekt pelegrinazhi si dhe xhaminë shekullore të zonës dhe rrënojat e Kalasë së fshatit Kabash. Bën gjithashtu lidhjen e shtigjeve turistike që përshkojnë zonën, Pukë-Kabash-Krrabë.



Zëvendëskomandanti i Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe njëkohësisht shef i Shtabit të USAEU-AF, gjeneralmajor Michael Wickman, vizitë në Forcën Tokësore.



Pas rreth 8 javësh programi arsimor në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, janë certifikuar sot me sukses 25 kursantë të Kursit të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetet “këmbësori” dhe “artileri tokësore”. Pas rreth 8 javësh programi arsimor në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, janë certifikuar sot me sukses 25 kursantë të Kursit të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetet “këmbësori” dhe “artileri tokësore”.



“ALB-ITA MLF/EUBG Expert meeting”, aktiviteti i organizuar në Forcën Tokësore në nivel ekspertësh, i cili synonte zhvillimin e bisedimeve për përfshirjen e efektivëve të Forcës Tokësore, në kornizën e Forcës Tokësore Shumëkombëshe dhe Grup Batalionit Europian (MFL/EUBG).



Kontingjenti KFOR-2 i trupave Komando të Regjimentit të Operacioneve Speciale me mision në Pejë, Kosovë, tregoi nivel të lartë ndërveprueshmërie me forcat aleate, gjatë stërvitjeve “Stronghold 3” dhe “Strident Rescue”.



Baza ajrore e Farkës, 55 vite fluturime humanitare, sakrificë, përgjegjësi

Baza ajrore e Farkës është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1967.

Zanafilla e kësaj baze është në vitin 1956, kur pilotë e teknikë shqiptarë u dërguan për t'u trajnuar në ish-Bashkimin Sovjetik në Rusi. Ndërsa në vitin 1957 u krijua njësi e parë e transportit ushtarak nr.5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa aeroplanë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandanti i njësive u emërua Peço Polena, komandant i trios së parë të MI-4 u emërua Petrit Malindi.

Mersin Minxha u emërua komandant i treshes së dytë të MI-1, ndërsa Refit Jazo ishte komandanti i avionëve JAK-18.

Më 4 shtator 1957, u bë fluturimi i parë.

Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena fluturoi në segmentin Tiranë-Shkodër-Tiranë.

Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i parë i helikopterëve", më 6 dhjetor 1967, dhe komandanti i saj u emërua Lulo Musaj. Regjimenti përfshinte tre skuadron e helikopterëve MI-4, një makinë për riparimin e helikopterëve, pistën për heliport, duke lejuar ngritjen dhe uljen e njëkohshme të helikopterëve, kazermave dhe kushteve normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur detyra.

Baza Ajrore e Farkës ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e trajnimeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por gjithashtu ka ndihmuar popullatën në emergjenca civile, veçanërisht në rastet e përmbytjeve, zonat malore të bllokuara nga bora, tërmetet apo edhe në kohë krizash. Kjo bazë gjithashtu ka ndihmuar

në trajnime të ndryshme të Forcave Ajrore, ose ushtrime të përbashkëta me forcat e njësive të tjera të Forcave të Armatosura, duke treguar cilësi të lartë dhe nivel të trajnimit të fluturimit.

Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze trajnohet intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme teknikën e ajrit, për të kryer detyra të tilla si: transportimi i trupave, operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), shpërndarja e ndihmës ushqimore ose transportimi i pacientëve në emergjenca civile.

Në vitet e fundit, infrastruktura e bazës është përmirësuar ndjeshëm, kryesisht për shkak të asistencës së ofruar nga Ushtria Italiane. Hekuro-

porti i ri është ndërtuar me të gjitha pajisjet përkatëse për uljet dhe ngritjet ditore dhe të natës.

U rindërtuan kazermat, si dhe makineritë për mirëmbajtjen e helikopterëve; drejtimi dhe kulla

e fluturimit është e pajisur me vegla moderne.

Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe misionin e saj.

Kjo bazë është një simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në stërvitje të përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm për të koordinuar veprimet për të përmbushur misionin.

Çdo vit kjo bazë mbart mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për transportin e të sëmurëve, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbytjeve, etj.

Shumica e personelit teknik dhe pilot



janë kualifikuar në shkollat dhe njësitë perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Disa prej drejtuesve të Bazës Ajrore të Farkës në vite janë: Lulo Musaj, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja.

55-vjetori i krijimit e gjen Bazën Ajrore të Farkës në prag të modernizimit me helikopterët Black Hawk, duke u bërë më operacionale edhe në misionet ndërkombëtare.

Në këtë 55-vjetor të Bazës Ajrore Farkë, kujtohen me respekt të veçantë dhe vlerësim çdo përpjekje, kurajë, mundim dhe dërsë e derdhur ndër vite nga breza të tërë pilotësh, teknikësh, specialistësh, të cilët kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre në përmbushje të misionit dhe detyrave në shërbim të qytetarëve dhe vendit.

Kontributi i dhënë ndër vite nga ata është transmetuar sot edhe tek brezat e rinj, që evidentohet me pjesëmarrjen e tyre në Emergjencat Civile në ndihmë të komunitetit, stërvitjet e përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, theksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të aleatëve të NATO-s për Ukrainën ndërsa ajo përballlet me luftën e agresionit të Rusisë. Stoltenberg tha se konflikti ka të ngjarë të hyjë në një fazë më të qetë gjatë dimrit, por se Rusia nuk po tregon asnjë shenjë se kërkon një fund paqësor të konfliktit. Këto komente shefi i NATO-s i bëri më 7 dhjetor 2022, duke iu drejtuar edicionit të gjashtë të Bordit Global të Financial Times, përmes lidhjes video. “Rusia po përpiqet të ngrijë konfliktin” në mënyrë që të “rigrupohet dhe të nisë një ofensivë më të madhe më vonë, sepse Ukraina tani ka momentumin”, - tha Stoltenberg. Ai përsëriti se Ukraina do të vendosë për kohën dhe përmbajtjen e çdo negociimi me Rusinë. “Sa më shumë që duam një zgjidhje paqësore, aq më urgjente është që të ofrojmë mbështetje ushtarake për Ukrainën”, - tha ai. Stoltenberg foli për “Financial Times” me Roula Khalaf në edicionin e mbajtur, ndërsa Europa po jeton në kohë të rrezikshme me kriza të shumta, të cilat po e bëjnë botën edhe më të ndërlkuar, me luftë, recesion, inflacion, krizë energjetike, emergjencë klimatike, ndërsa lufta në Ukrainë, ka përmbysur rendin ndërkombëtar dhe po shkon tashmë në muajin e 10-të të saj.

Ukraina, qëndrueshmëria, besimi në fitore dhe rimarrja e territorit

Raportet nga Ukraina tregojnë jo vetëm për qëndrueshmërinë e ukrainasve, por edhe besimin e tyre për fitoren e luftës dhe për rimarrjen e të gjithë territorit vitin e ardhshëm. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha lidhur me këtë se luftërat janë të vështira për t'u parashikuar, por NATO ishte shumë e saktë kur parashikoi pushtimin. “Në fakt zbuluam, ndamë inteligjencën më shumë se një vit më parë, vjeshtën e kaluar, shumë muaj para pushtimit, duke thënë saktësisht atë që do të ndodhte që Rusia po planifikonte dhe po përgatiste një pushtim të plotë të Ukrainës. Pra, kur ndodhi pushtimi, ne ishim të përgatitur mirë, aktivizuar planet tona të mbrojtjes dhe vendosëm dhjetëra mijëra trupa të tjera në pjesën lindore të Aleancës dhe filluam të ofrojmë edhe më shumë mbështetje për Ukrainën. Kurse tani Rusia po përpiqet të ketë një lloj “ngrijje” të kësaj lufte të paktën për një periudhë të shkurtër kohore që të mund të rigrupohen, riparohen, rikuperohen. Ata po përpiqen të nisin një ofensivë më të madhe pranverën e ardhshme, kurse NATO po mbështet Ukrainën në të drejtën e saj për vetëmbrojtje. Ukraina po mbron vendin e vet dhe aleatët dhe partnerët e NATO-s po ofrojnë mbështetje të paprecedentë për këto përpjekje nga ukrainasit. Presidenti Putin bëri dy gabime të mëdha strategjike, kur vendosi të pushtonte Ukrainën, nënvlerësoi ukrainasit trimërinë dhe guximin e Forcave të Armatosura të Ukrainës, popullit ukrainas dhe liderit politik ukrainas me Presidentin Zelenskyy, por ai gjithashtu nënvlerësoi forcën e aleatëve dhe partnerëve të NATO-s në angazhimin e saj për ta qëndruar pranë Ukrainës dhe për ta mbështetur atë. Aleatët e NATO-s kanë mbështetur Ukrainën për shumë vite, veçanërisht që nga viti 2014, sidomos aleatët si SHBA, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, kanë trajnuar Forcat e Armatosura të Ukrainës, duke u bërë më të forta dhe shumë më të mirë pajisura në shkurt 2022, sesa kur Rusia e pushtoi për herë të parë në vitin 2014. Ajo që NATO ka demonstruar gjatë viteve dhe veçanërisht që nga pushtimi, tregon se aleatët janë të gatshëm të mbështesin Ukrainën, sepse ata e kuptojnë se nëse Putini fiton, do të jetë një tragjedi për ukrainasit, por do të jetë gjithashtu jashtëzakonisht serioze për të gjithë ne. Kjo do t'i bëjë aleatët e NATO-s më të prekshëm dhe botën më të rrezikshme dhe për këtë arsye ne nuk mund të lejojmë që presidenti Putin të fitojë”.

Mbështetja me armatim e me sisteme moderne për Ukrainën
“Aleatët e NATO-s kanë ofruar dhe po ofrojnë një nivel të paprecedentë të mbështetjes ushtarake për Ukrainën,



gjithashtu edhe me sisteme moderne. Aleatët kanë siguruar automjete të blinduara, tanke luftarake, sisteme të avancuara të mbrojtjes ajrore dhe një gamë të gjerë armësh të ndryshme, dhe po shqyrtohen edhe sistemet specifike. “Ne gjithmonë mendojmë të shtojmë më shumë sisteme, - tha Sekretari i Përgjithshëm, - por po aq e rëndësishme sa shtimi i sistemeve të reja është të sigurohet që sistemet, armët, që kemi dorëzuar tashmë, janë në të vërtetë funksionale, po punojnë në një mënyrë efektive, që do të thotë se ata kanë nevojë për një sasi të madhe municioni, pjesë këmbimi dhe gjithashtu mirëmbajtje. NATO ka sisteme të avancuara HIMARS, sisteme të avancuara të mbrojtjes ajrore si NASAMS, ose Crotale dhe RST nga Gjermania, ne po shqyrtojmë vazhdimisht se çfarë lloj sistemesh duhet të ofrojmë”. Lidhur me dronët që u përdorën për të sulmuar një bazë ushtarake ruse, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se nuk kishte më shumë informacion për ato incidente specifike, por ai tha se “ajo që ne shohim është se Ukraina po mbrohet dhe ne duhet ta kuptojmë këtë në një kontekst më të gjerë, pasi shohim sulme të përditshme nga Rusia ndaj qyteteve të Ukrainës, ndaj infrastrukturës kritike. Ajo që Rusia përpiqet të bëjë është të armatosë dimrin, të privojë civilët ukrainas nga uji, energjia elektrike, ngrohja, kur ata po hyjnë në dimër, dhe kjo është një lloj lufte brutale që në fakt prek të gjithë civilët, kjo tregon brutalitetin e pushtimit rus dhe Ukraina ka të drejtë të mbrohet nga këto lloj sulmesh.”

Lidhur me përfundimin e luftës dhe nëse është koha për negociata, shefi i NATO-s u përgjigj se: “Duhet të jetë Ukraina ajo që vendos kohën dhe kushtet për negociatat. Ukrainasit janë gjithashtu të shqetësuar për përpjekjet e Rusisë që kërkon të ketë një lloj pushimi të shkurtër ose një ngrijje të shkurtër të konfliktit në mënyrë që ajo të rimarrë trupat e saj, të rigrupohet dhe më pas të nisë një ofensivë, tjetër më të madhe më vonë, sepse tani Ukraina ka vullmin. Si shumica e luftërave, edhe kjo luftë mund të përfundojë në tryezën e bisedimeve, por ajo që ndodh rreth asaj tryeze varet absolutisht nga situata në fushën e betejës”, - tha Stoltenberg për “Financial Times”.

“Rezultati i këtyre negociatave, i cili siguron që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran dhe i pavarur, kërkon mbështetje ushtarake për Ukrainën dhe e vetmja paqe e qëndrueshme duhet të jetë një paqe e drejtë. Nëse agresori fiton, kjo nuk do të na japë një paqe të qëndrueshme. Pra, paradoksi është se sa më shumë që duam një zgjidhje paqësore të negociuar që siguron mbizotërimin e Ukrainës, aq më urgjente është që të

ofrojmë mbështetje ushtarake për Ukrainën për të krijuar kushtet për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme në Ukrainë. Por nga ana tjetër Rusia nuk ka treguar asnjë shenjë të përfshirjes në negociata që respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Nuk i takon NATO-s dhe Brukselit të vendosë. U takon ukrainasve të vendosin se kur është koha e duhur për të filluar negociatat dhe për të rënë dakord për kushtet. Bëhet fjalë për një komb sovran, të pavarur, demokratik, i cili po mbrohet nga një luftë agresioni. Ata kanë të drejtë të mbrohen dhe NATO i mbështet në të drejtën e vetëmbrojtjes të sanksionuar në traktatin e OKB-së”, - tha Stoltenberg. “Në një fazë, kjo luftë ka shumë të ngjarë të përfundojë në tryezën e bisedimeve. Por gjasat për ndonjë rezultat të pranueshëm rriten me mbështetjen tonë për Ukrainën, kjo është absolutisht e lidhur me atë që ndodh në fushën e betejës”, - tha ai.

Përkallëzimi bërthamor, përpjekjet për një zgjidhje politike Marrëdhënia me Rusinë

Disa javë, raportet treguan retorikën e Moskës dhe të presidentit Putin, që rriti shqetësimet midis aleatëve të NATO-s për përdorimin e mundshëm të armëve bërthamore. Por retorika bërthamore nga pala ruse, veçanërisht në fillim të vjeshtës, ishte e pamatur dhe e rrezikshme. “Rusia duhet të dijë se çdo përdorim i armëve bërthamore do të ndryshonte totalisht karakterin, natyrën, konfliktin dhe një luftë bërthamore nuk mund të fitohet kurrë dhe nuk duhet të luftohet kurrë. Edhe pse kohët e fundit janë ulur zërat NATO mbetet vigjilente, ne monitorojmë nga afër se çfarë po bën Rusia, dhe aleatët i kanë dërguar një mesazh shumë të qartë Rusisë se do të ketë pasoja të rënda për Rusinë, por që sigurisht një luftë bërthamore nuk duhet të bëhet kurrë. Gjatë vitit të kaluar kemi parë përdorimin e forcës brutale të Putinit për të arritur qëllimet e tij politike. Pikërisht për këtë është e rëndësishme që ai të mos fitojë, sepse nëse presidenti Putin fiton në Ukrainë, do të përfundojë gjithashtu me rezultatin që një komb i pavarur sovran në Evropë është sulmuar nga një komb tjetër dhe fiton agresori. Kjo do të dërgojë gjithashtu një mesazh shumë të keq për udhëheqësit autoritarë në të gjithë botën dhe gjithashtu për Presidentin Putin, se kur përdorin forcën, kur shkelin ligjin ndërkombëtar dhe kur pushtojnë një vend tjetër, ata mund të arrijnë atë që duan. Dhe kjo do t'i inkurajojë ata të përdorin edhe më shumë forcë dhe ta bëjnë atë përsëri. Pra, kjo është arsyeja pse është në interesin tonë të sigurisë të sigurojmë që Presidenti Putin të mos fitojë, sepse ajo që kemi mësuar është se ai ka një gatishmëri për të përdorur forcën për të

arritur qëllimet, shumë njerëz shpresonin se nuk ishte kështu, por ne kemi parë të kundërtën tani”.

NATO nga ana e saj për dekada u përpoq për një marrëdhënie konstruktive dhe më të mirë me Rusinë, për një dialog kuptimplotë edhe disa javë para pushtimit. Aleanca, bëri propozime me shkrim se si të angazhoheshin me Rusinë në përpjekje për të parandaluar luftën, për të adresuar disa nga shqetësimet që ata ngritën. Por presidenti Putin vendosi të vazhdojë me pushtimin e tij, pavarësisht nga përpjekjet për të gjetur një zgjidhje politike. “Pra, ne duhet të kuptojmë se kur kjo luftë përfundon, kjo nuk do të thotë që ne të kthehemi në një lloj marrëdhënieje të mirë ose normale me Rusinë. Ne duhet të jemi të përgatitur për një marrëdhënie të vështirë me Rusinë për një kohë të gjatë, që do të thotë se ne duhet të investojmë në mbrojtjen tonë, të vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen kolektive të NATO-s për të siguruar që konflikti në Ukrainë të mos përshkallëzohet dhe të bëhet një luftë e plotë midis NATO-s dhe Rusisë. Dhe sigurisht, ne nuk mund të kthehemi dhe të jemi të varur nga gazi rus. Këto janë pasojat afatgjata që do të ketë edhe pas përfundimit të luftës”, - theksoi Stoltenberg dhe çdo gjë duhet bërë në rendin e duhur. “Presidenti Putin filloi një luftë agresioni dhe ai duhet t'i japë fund kësaj lufte, përgjegjësia jonë kryesore, detyra urgjente, është të mbështesim Ukrainën për të mbrojtur veten dhe për të krijuar kushtet për një zgjidhje të negociuar që siguron që Ukraina të mbizotërojë si një komb i pavarur sovran në Ukrainë. Kjo duhet të jetë baza për çdo zgjidhje të negociuar dhe duhet të jetë Ukraina ajo që vendos se cilat janë kushtet e pranueshme për ta. Kurse NATO pas përfundimit të luftës, do të vazhdojë të ketë një marrëdhënie me Rusinë, që do të thotë se duhet të kemi linja ushtarake të komunikimit, duhet të angazhohemi në kontrollin e armëve. Kjo luftë ka dëshmuar rëndësinë e të pasurit një mbrojtje të fortë kolektive, siç është rritja e pranisë ushtarake të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës me grupe betejë, me gatishmëri të lartë dhe me më shumë shpenzime për mbrojtjen, që nga viti 2014. Por ne duhet të bëjmë më shumë nga kjo për të siguruar që të mos ketë vend për llogaritje të gabuara apo keqkuptime në Moskë rreth gatishmërisë së NATO-s për të siguruar ose mbrojtur të gjithë aleatët. NATO nuk provokon konflikt, por po parandalojmë konflikt dhe po ruan paqen”.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se që nga viti 2014, të gjithë aleatët e kuptuan se jetojmë në një botë më të rrezikshme. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, aleatët e NATO-s reduktuan shpenzimet e mbrojtjes dhe numrin e ushtarëve që kishim në Evropë, por pas vitit 2014, NATO ka zbatuar përf forcimin më të madh në mbrojtjen kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Për herë të parë në historinë e saj ajo ka grupe luftarake në pjesën lindore të saj. “Ne kemi dhjetëra mijëra trupa nën komandën e NATO-s të mbështetur nga fuqi të konsiderueshme ajrore dhe detare dhe morëm gjithashtu vendime të rëndësishme tani në qershor për të forcurat më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë. Dhe e mira është se që nga viti 2014, të gjithë aleatët e NATO-s kanë investuar më shumë në mbrojtje. Nga ana tjetër aleatët mund të kenë vlerësime të ndryshme, analiza të ndryshme në kryeqytete të ndryshme, kjo është e natyrshme, ne jemi 30 aleatë, por ajo që kemi bërë së bashku është të demonstrojmë vullnetin për të bërë më shumë dhe paradoksi është se presidenti Putin po merr pikërisht të kundërtën e asaj që donte. Ai shkoi në luftë për të marrë më pak NATO. Ajo që ai ka parë është më shumë NATO. Më shumë prani ushtarake e NATO-s në pjesën lindore të Aleancës, më shumë anëtarësim në NATO, Finlanda

dhe Suedia po i bashkohen NATO-s si pasojë e drejtpërdrejtë e luftës brutale të Rusisë dhe Finlanda në NATO do të thotë se ne po dyfishojmë kufirin me Rusinë. Pra, Presidenti Putin bëri gabime të mëdha, gabime strategjike, kur pushtoi Ukrainën, dhe kjo reflektohet gjithashtu në faktin se ai në fakt po merr më shumë mbështetës të NATO-s plus NATO-s.

Ka dallime midis aleatëve të NATO-s dhe ka pasur gjithmonë dallime midis aleatëve të NATO-s që nga kriza e Suezit në 1956, ose lufta në Irak në 2003, por ajo ka qenë gjithmonë në gjendje të bashkohet rreth detyrës thelbësore të saj për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin. Që pas Luftës së Ftohtë, NATO ka përmirësuar praninë ushtarake në Evropë, pas veprimeve të Rusisë për të prishur paqen në Evropë. Ne u përpoqëm për një marrëdhënie më konstruktive me Rusinë. Por që nga viti 2014, ne kemi parë një ndryshim të madh në NATO. Dhe kjo është reflektuar si në atë që ne bëjmë në terren, me sistemet e armëve, por edhe në krijimin e fushave të reja ushtarake, hapësirës kibernetike dhe investimit në sisteme të reja të avancuara të armëve të nivelit të lartë për të mbrojtur veten dhe për rrjedhojë edhe kur pushtimi ndodhi në shkurt, ishim të përgatitur mirë. NATO aktivizoi planet e mbrojtjes që i dhanë më shumë autoritet Komandantit Suprem Aleat SACEUR, vendosi trupa shtesë, dyfishoi numrin e grupeve të betejës në pjesën lindore të Aleancës dhe kjo është reflektuar në transformimin e madh të NATO-s që nga viti 2014”.

Marrëdhënia me Kinën, Finlanda dhe Suedia ende në procesin e anëtarësimit

Kina nuk ka qenë në agjendën e NATO-s, hera e parë që Aleanca iu drejtua Kinës ishte në vitin 2019 dhe në Konceptin e ri Strategjik, për të cilin NATO ra dakord në qershor të këtij viti, në fakt i drejtohet Kinës gjërësisht në kushte të dakorduara. Në dokumentin më të rëndësishëm, Konceptin Strategjik, thuhet qartë se Kina nuk është një kundërshtar, duhet të vazhdojmë të angazhohemi me Kinën, për çështje si ndryshimi i klimës, kontrolli i armëve etj. “Por në të njëjtën kohë, NATO duhet të ketë parasysh se ngritja e Kinës mund të shkatërrojë sigurinë e Aleancës, pasi ata po investojnë shumë në aftësi të reja moderne të teknologjisë së re. Ajo po godet të drejtat demokratike si në Hong Kong, pakicat, por gjithashtu edhe sjelljen e saj shtrënguese ndaj fqinjëve. Pastaj Kina po na afrohet më shumë”, - tha Stoltenberg. Ai tha se nga mësimet e nxjerra nga lufta në Ukrainë tregojnë se është e rrezikshme “të varem shumë nga regjimet autoritare për mallra thelbësore si gazi rus dhe nuk do të bëjmë të njëjtin gabim që bëmë, duke u varur shumë nga mallrat kritike që vijnë nga Kina”.

“Finlanda dhe Suedia janë ende në procesin e anëtarësimit, në pritje të vendimit të Turqisë dhe Hungarisë për të ratifikuar protokollin”, - tha në mbyllje, kur u pyet Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai tha se “Deri më tani ky ka qenë procesi më i shpejtë i anëtarësimit në historinë moderne të NATO-s”. Finlanda dhe Suedia aplikuan për anëtarësim në maj, dhe më pas në qershor, të gjithë aleatët e NATO-s, edhe Turqia, ftuan Finlandën dhe Suedinë të bëhen anëtarë. Të gjithë aleatët e NATO-s nënshkruan protokollin e anëtarësimit dhe deri më tani 28 nga 30 aleatë i kanë ratifikuar protokollin në parlamentet kombëtare dhe sipas standardeve të NATO-s. “Kjo është shumë e shpejtë. Hungaria ka premtuar të nënshkruajë në fillim të vitit të ardhshëm dhe gjithashtu Turqia do ta ratifikojë, pasi ka ardhur koha që të gjithë aleatët të finalizojnë procesin e ratifikimit”, - tha Stoltenberg, për “Financial Times”.

“Nuk duhet, nuk mundemi t’i dorëzohemi dëshpërimit!”

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i bashkohet lutjeve për Ukrainën

Mircea Geoană, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s foli në Mëngjesin e 25-të Evropian të Lutjes në Bruksel, më 7 dhjetor. Në mëngjesin e lutjes morën pjesë eurodeputetë, diplomatë, zyrtarë dhe drejtues biznesi.

Fjala nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană, në 25-vjetorin e Mëngjesit Evropian të Lutjes në Parlamentin e BE-së

Faleminderit Peter. Julia, Gor, zonja dhe zotërinj!

Është një kënaqësi e madhe t’ju bashkohem sot, në lutje dhe falënderime për shumë gjëra për të cilat mund të jemi mirënjohës. Në kohë të errëta si këto, është e lehtë të harrosh të falënderosh dhe shpresa mund të ndihet si naivitet. Por ne nuk duhet, nuk mundemi t’i dorëzohemi dëshpërimit.

Psalmi 100 thotë: “Sepse Zoti është i mirë dhe dashuria e tij vazhdon përjetë; besnikëria e tij vazhdon gjatë gjithë brezave, dashuria e tij zgjat, duron në kohë të mira dhe të këqija, përmes paqes dhe luftës, përmes lirisë dhe shtypjes”. Unë e di që kjo është e vërtetë. Unë jam rritur, si shumë të tjerë këtu, nën komunizëm. Nuk kishim të drejta, nuk kishim liri. Pushtetarët tanë zgjodhën vetë dhe kundërshtimi u përball me brutalitet dhe barbarizëm. Por ne duam. Edhe në ditët më të errëta, ne kishim shpresë. Shpresonim se një ditë do të ishim të lirë. Të lirë për të zgjedhur, për të menduar, për të folur. Dhe ajo ditë erdhi. Muri ra dhe komunizmi po ashtu. Kishim mundësi të reja dhe i shfrytëzuam. Demokracia, anëtarësimi në NATO dhe Bashkimin Evropian, duke çimentuar lirinë, sigurinë dhe prosperitetin tonë.

Tani presidenti Putin po kërkon të kthejë kohën pas me një luftë agresioni kundër një kombi paqësor, Ukrainës sovrahe dhe demokratike.

Shumë mijëra janë të vdekur. Shtëpitë, shkollat dhe spitalet janë shkatërruar. Bombardimi i Rusisë ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës synon të përdorë vetë dimrin si një armë lufte. Është në kohë lufte që drita është më e vështirë për t’u parë. Por kjo është kur ne duhet të mbështetemi në busullën tonë të brendshme për të na udhëhequr në rrugën e duhur. Kur duhet të bashkohemi, të tregojmë solidaritet dhe të mbështetemi më thellë në besimin tonë.

Besimi ynë, se e mira do të mbizotërojë, se liria do të mbizotërojë, se një ditë Ukraina do të mbizotërojë. NATO dhe BE po punojnë së bashku për ta bërë atë ditë të vijë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ne e kemi mbështetur Ukrainën që kur ajo fitoi për herë të parë pavarësinë e saj. Ne e rritëm atë mbështetje pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Putin në 2014. Dhe që nga pushimi i plotë i Rusisë në shkurt, aleatët e NATO-s po ofrojnë mbështetje të paprecedentë ushtarake, humanitare



dhe financiare. Vetëm javën e kaluar, ministrat e Jashtëm të NATO-s u takuan në Bukuresht dhe u zotuan për ndihmë të mëtejshme, me më shumë armë për

të ndihmuar Ukrainën të mbrohet dhe më shumë ndihma jo-vdekjeprurëse, si karburantet dhe gjeneratorët, si pjesë e Paketës Gjithëpërfshirëse të Ndhmës së

NATO-s, për të ndihmuar Ukrainën t’i kalojë muajt e gjatë të dimrit.

NATO nuk është palë në luftë, por ne do të vazhdojmë të mbështesim

Ukrainën për aq kohë sa të duhet. Ne jemi të bashkuar në solidaritetin tonë me popullin ukrainas dhe të drejtën e tij për të jetuar në paqe dhe liri. Ne nuk do të tërhiqemi. Sepse nëse e bëjmë këtë, mësimi i mësuar nga Presidenti Putin dhe liderë të tjerë autoritarë është se ata mund t’i arrijnë qëllimet e tyre përmes agresionit dhe dhunës. Ata do të inkurajohen të përdorin forcën përsëri, duke e bërë botën tonë më të rrezikshme. Kjo nuk mund të ndodhë.

Mbështetja e NATO-s, mbështetja e Evropës, mbështetja e Amerikës së Veriut, por më së shumti trimëria, aftësia dhe vendosmëria e jashtëzakonshme e forcave të armatosura të Ukrainës, po i jep popullit të saj dhuratën më të çmuar nga të gjitha - shpresën.

Shpresoj se lufta do të përfundojë. Shpresoj se Ukraina do të fitojë dhe shpresoj se një ditë do të qëndrojë e fortë dhe e lirë brenda familjes euroatlantike të kombeve. Historia na tregon se shpresa mund të bëhet realitet. Këtë më thotë përvoja ime. Le të sigurohemi që të gjithë ta bëjnë edhe një herë, për Ukrainën dhe për të gjithë ne.

Faleminderit, dhe Zoti ju bekoftë!

PËRFUNDON NË ESTONI STËRVITJA “KOALICIONI KIBERNETIK - 2022”

U përfshinë mbi 1000 mbrojtës kibernetikë nga 26 aleatë të NATO-s

NATO ka përfunduar stërvitjen e saj më të madhe vjetore të mbrojtjes kibernetike, “Koalicioni Kibernetik - 2022”, që përfshiu më shumë se 1000 mbrojtës kibernetikë nga 26 aleatë të NATO-s, Finlanda dhe Suedia e ftuar, si dhe Gjeorgjia, Irlanda, Japonia, Zvicra, Bashkimi Evropian, dhe pjesëmarrës nga industria dhe akademja. Aktiviteti u zhvillua në Talin, Estoni, si dhe nga distanca.

“Pjesa më e mirë e këtij ushtrimi, është se ai është një mjedis bashkëpunues dhe bashkëpunues dhe nuk është një konkurrencë”, - tha komandanti Charles Elliott, Drejtor i Ushtrimeve të Koalicionit Kibernetik - 2022, nga Marina e Shteteve të Bashkuara. “Duke ndërtuar mbi suksesin e këtij viti, ne do të përfshijmë më shumë mësim të nxjerrë nga bota reale ndërsa shkojmë në vitin e ardhshëm”, - shtoi ai.

Stërvitja vjetore e Koalicionit Kibernetik të udhëhequr nga Komanda Aleate e NATO-s për Transformimin teston dhe trajnon mbrojtësit kibernetikë nga e gjithë Aleanca në aftësinë e tyre për të mbrojtur NATO-n dhe rrjetet kombëtare.

Koalicioni Kibernetik - 2022 është një vend i përsosur për eksperimente, nxitje të luftës në hapësirën kibernetike dhe zhvillimin e aftësive. Përdoret ndër të tjera për të testuar dhe vërtetuar koncepte, për të kapur kërkesat ose për të eksploruar teknologjitë në zhvillim dhe përçarës, në mbështetje të operatorëve dhe komandantëve ushtarakë. Fushata eksperimentale e Koalicionit Kibernetik - 2022 përfshinte eksperimente mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale për të ndihmuar në përballimin e kërcënimeve kibernetike, në standardizimin e mesazheve kibernetike për të nxitur shkëmbimin e informacionit dhe mbi shfrytëzimin e Inteligjencës së Kërcënimeve Kibernetike për të informuar Ndërgjegjësimin Situativ të Hapësirës Kibernetike. Fushata eksperimentuese e Koalicionit Kibernetik koordinohet nga Komanda Aleate e Transformimit dhe kryhet çdo vit në bashkëpunim me palët e interesuara nga organizatat e NATO-s, kombet, industria dhe akademja.

Koalicioni Kibernetik - 2022 bazohet në një skenar sfidues, realist, ku një aktor i fuqishëm kërcënim përpigjet të komprometojë një mision të NATO-s, duke kryer operacione kibernetike të avancuara dhe të sofistikuar. Këto operacione nxisin koordinimin dhe bashkëpunimin e mbro-

jtësve kibernetikë pjesëmarrës të NATO-s, aleatëve dhe partnerëve. Skenari ndihmon në përgatitjen e mbrojtësve kibernetikë për sfidat kibernetike të jetës reale, duke përfshirë sulmet në infrastrukturën kritike, si dhe ndërprerjen e NATO-s dhe aseteve aleate gjatë operacioneve.

“Aktorët keqdashës kërkojnë të degradojnë infrastrukturën tonë kritike, të ndërhyjnë në shërbimet tona qeveritare, të nxjerrin inteligjencë, të vjedhin pronën intelektuale dhe të pengojnë aktivitetet tona ushtarake. Aleatët janë të përkushtuar të mbrojnë infrastrukturën e tyre kritike, të ndërtojnë elasticitet dhe të forcojnë mbrojtjen e tyre kibernetike. Ne do të vazhdojmë të rrisim mbrojtjen nga aktivitetet të tilla keqdashëse kibernetike në të ardhmen dhe mbështesim njëri-tjetrin për të penguar, mbrojtur dhe kundërshtuar spektrin e plotë të kërcënimeve kibernetike, duke përfshirë marrjen në konsideratë të përgjigjeve të mundshme kolektive”, - tha Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin, gjenerali Philippe Lavigne, nga Forca Ajrore dhe Hapësinore Franceze.

Koalicioni Kibernetik është stërvitja kryesore vjetore e NATO-s për mbrojtjen kibernetike dhe një nga më të mëdhenjtë në botë. Ai është planifikuar dhe kryer nga Komanda Aleate e Transformimit nën qeverisjen e Komitetit Ushtarak.



Gani Haloçi, ushtaraku me shpirt atdhetar dhe mirësi njerëzore




Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Gani Haloçi ishte lindur në Prongji të krahinës së Kardhiqit të trevës së Labërisë, më 6 dhjetor 1909.

Ai erdhi në jetë në një kohë pushtimi, ndërkohë që fshati dhe treva e tij ishin shquar për atdhetari dhe kundërshtim të të gjithë pushtuesve. Babai i tij, Hyseni dhe nëna Bejushja trashëgonin vetitë më të mira të urtësisë dhe mençurisë, që kishin përcjellë brez pas brezi historinë e fisit dhe mbarë trevës labe, bëmat nëpër luftëra, këngët dhe rrëfimet e trimërive. Në këtë ambient familjar u rrit dhe u burrërua njeriu që mbarë krahina ia dëgjoi bëmat e tij, kur të gjithë e thërrisnin me pseudonimin e LANÇ-it, “Ustai”. Ai ishte dhe ngeli usta i halleve të popullit, u trupëzua njësh me popullin dhe në momentet historike, kur në vatrën shqiptare kishte pllakosur zija e pushtimit ai u bë misionar i lirisë dhe çlirimit.

Në mars 1927, Ganiu kreu detyrën si ushtar në kohën e Republikës së parë shqiptare në Durrës. Ushtrinë e filloi me Gani Diten dhe bashkëfshatarin Stefan Gogo si dhe Hetem Arapin nga Kardhiqi. Nga Durrësi shkon me shërbim në Shkodër, ku në Lezhë takon dhe Iliaz Mehmetin e Medi Pogaçen nga Plesati, Novruz Bellon nga Fushëbardha. Në çdo fshat të trevës labe gjen trashëgimi të fuqishme brezash, mençuri natyrale, që mëkohet që në djep, ashtu sikurse u mëkua Gani Haloçi, i cili u kalit në kudhrën e jetës. Pushtimi fashist i 7.4.1939 ngjalli revoltë dhe kundërshtim të hapur në të gjithë Shqipërinë, edhe në Prongji, krahinën e Kardhiqit dhe mbarë Labërinë.

Ideali i lirisë, i mbrojtjes së gjuhës, identitetit dhe pavarësia ishin ngulitur thellë në zemrën e Gani Haloçit. Në momentet më vendimtare të vendit, në vitin 1942, kur flaka e shpërthimit kundër pushtuesve po rritej, asnjë shqiptar i ndershëm nuk mund të rrinte duarkryq. Ishte dëshmitar kur Muzafer Asqeriu, Kapo Boço, Bajram Sinojmeri mbërritën në Prongji dhe ndezën zjarrin kryengritës kundër pushtuesve themeluan Këshillin antifashist të Prongjisë me në krye Hamza Makashin. Këshilli nacionalçlirimtar i Prongjisë ishte i dyti pas atij të Mashkullorës të ngritur në krahinë. Gani Haloçi ishte luftëtar i orëve të para të krahinës së Kardhiqit, njerëzor dhe me vlera të spikatura atdhetare, një bilbil që shumë shpejt do ta gjente veten në radhët e çetës Partizane të krahinës bashkë me Dilaver Habil Poçin, Mitat Kondin e shumë të tjerë. Ai ishte burrë me ndërgjegje të rrallë atdhetarie, një gjurmë e rëndë dhe e spikatur, një rrënjë e thellë e trevës labe, një degë e mbushur me visare, me muzë poetike, një rapsod e këngëtar, një njeri që sado vite të shkojnë shquhet që larg



Në përkujtim të luftëtarit dhe patriotit atdhetar, simbolit të urtësisë dhe dashurisë njerëzore, komisarit të formacionit partizan të parë, të çetës “Çerçiz Topulli”, birit të Prongjisë, të krahinës së Kardhiqit, të Labërisë dhe të gjithë Shqipërisë, ish-oficerit shembullor të strukturave të mbrojtjes e sigurisë nënkolonel Gani Haloçi. Biri i fshatit Prongji, Gani Haloçi (6.12.1909-2.12.1982), ka qenë partizan i orëve të para, komisar i parë i çetës së krahinës së Kardhiqit, nënkomandant i kësaj çete, Komandant i vendit për Gjirokastrën, komisar i komandës së qarkut në Fushëbardhë, anëtar i këshillit nacionalçlirimtar të krahinës dhe pas luftës në detyra e funksione me shumë përgjegjësi si ushtarak madhor në MB, në Tepelenë, Gjirokastrë, Përmet e Sarandë. Përgatitur në kuadër të 80-vjetorit të krijimit të çetës partizane “Çerçiz Topulli” 12.12.1942-12.12.2022.

në vitin 2016 rikthimi në shtëpitë e tyre, ndërkohë që në gjithë Krahinën e Kardhiqit ishin djegur më shumë se 540 shtëpi nga dora gjakatare greke andarte. Bijtë e Prongjisë si Ganiu që e pasuan Bajram Ligu e mbajtën lartë flamurin e atdhetarisë e çlirimit si dhe mirësisë njerëzore.

Çeta “Çerçiz Topulli”, emërndritur në historinë e LANÇ-it

Kundërshtimi i pushtimit ishte një revoltë e brendshme e popullit. Gani Haloçi ishte ndër të parët në Prongji dhe krahinë që filloi punën e organizuar për ngritjen e popullit në Luftën antifashiste, që në mars 1942, kur me vendim të komitetit qarkor të Gjirokastrës, Dilaver Poçi transferohet nga Saranda në Krahinën e Kardhiqit si organizator kryesor. Rugët e atdhetarëve të flaktë bashkoheshin në ideale të mëdha antifashiste. Ndërkohë që lëvizja nacionalçlirimtare mori hov dhe luftëtarët e parë binin në betejë, sikurse ishte dhe vrasja e Muzafer Asqerit në korrik 1942, zemërimi popullor erdhi në ngritje. Lufta e

si majat e maleve të trevës së Labërisë. Jeta plot dinjitet e krenari e Gani Haloçit bëri që të shkruante një histori suksesi në jetë, që shprehte plotësisht identitetin, krenarinë, trimërinë e mençurinë e një krahine vitale dhe me emër në Shqipëri. Ai diti t’i kthehet vullshëm ringritjes së jetës, nga lufta në punë, duke bërë një jetë plot dinjitet. Ai e jetoi jetën si idealist atdhetar. Me urtësi e mençuri që e karakterizonte spikati si intelektual në mes-shekullin e XX. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare vendosi në provë shqiptarët dhe në fakt brezit që i takoi të bënte luftën, nuk mori meritat, por një përgjegjësi

të madhe përpara kombit dhe historisë.

Prongjia e Bajram Ligit, streha e Çerçiz Topullit

Bajram Ligu/Prongjia dhe Hito Labi/Lekdushi i dhanë emër historik jo vetëm Prongjisë e Lekdushit, por gjithë Labërisë e më gjerë. Prongjia e Gani Haloçit i kishte të gjallë kujtimet e trimërisë së bashkëfshatarëve të tyre por dhe plagët, ato plagë që sikurse thoshte Bajram Ligu, “Shenja e plagës së hasmit nuk fshihet”. Ndërkohë që Prongjia ishte strehëza e trimit të rrallë Çerçiz Topullit si dhe e çetës së tij, ku bënë pjesë edhe bijtë e Prongjisë Bajram Ligu dhe Lame Skreli

etj., por dhe mbështetës të shumtë si Hysen Haloçi, Riza Ligu, Malo e Harziko Maliqi, Begë Haxhiu etj. Ishin ata që e strehuan çetën e Çerçizit dhe të Muharrem Rushitit. Edhe sot këndohet kënga në mbarë Labërinë:

“Hito labi me Bajramë,/Gjirokastrë bënë hatanë, Mu te furra në të dalë/Me binbashin ballë për ballë, dy rovole bashkë ja dhanë”. Prongjia e Gani Haloçit kishte përjetuar tmerret e 1914-tës kur, “Gratë e Kurveleshit/Labërisë./Shkojnë për në Vlorë,/Me djepe ngarkuar,/Me foshnja në dorë...”, e më tej më qershor 1914 në fushën e Drashovicës dhe

pabarabartë e shqiptarëve me pushtuesit kishte filluar. Tashmë ishte lëshuar kushtrimi i lirisë: “Të bashkohemi”, “Të lëmë mënjatë mëritë, grindjet, t’i japim dorën njeri tjetrit”, “Të armatosemi”, “Ta kundërshtojmë energjikisht armikun”, “Asnjë taksë, asnjë ushtar, asnjë milic për fashizmin, të rrëzojmë pushtetin e vjetër të kryepiqësive, të komunave e xhandarmërinë, të ngremë pushtetin e popullit” etj. Këto ishin thirrjet e një populli të tërë të shtypur në mbarë krahinën e Kardhiqit, në Prongji, Kardhiq, Fushëbardhë, Zhulat, Mashkullorë, Plesat e Humelicë. Një ditë para krijimit të çetës, më 11.12.1942, disa aktivistë si Islam Poçi, Hariz Shalari, Nimet Velu, Neshat Kondi, etj., organizuan fushëbardhasit që të prisnin luftëtarët e parë të krahinës. Dilaver Poçi mbledhi në Zhulat djemurinë antifashiste bashkë me Ago Topullin, nipin e Çerçiz Topullit dhe prej andej u nisën për në Fushëbardhë. Një grup tjetër që drejtoheshin nga Gani Haloçi ishin gati që, më datën 7 dhjetor 1942, bashkë me Neshat Kacan, Hajro e Mehmet Skrelin, Demir Kadëna, Thoma Pano, Sadik Xharro, Hamza Makashi, Rait Bala. Por të gjithë fshatrat e krahinës së Kardhiqit ishin gjithë sy e veshë nga fshati Fushëbardhë. Grumbullimi i çetës fillimisht u bë në Rrapin e Fushëbardhës, ku komandant u caktua Dilaver Poçi, Komisar Gani Haloçi dhe intendent Mitat Kondi. Në çetë mermin pjesë djem nga fshatrat Fushëbardhë, Zhulat, Prongji dhe nga të gjitha fshatrat e krahinës. Formacioni partizan i çetës piu unë në çezmën e Ferrëzës dhe mori udhë drejt Lëmëdhit e bregut të Erëzës. Nga 27 luftëtarë çeta shpejt u rrit në 36 partizanë e më tej e kaloi numrin 70-80 luftëtarë nga të cilët përmendim Dilaver Poçi, Gani Haloçi, Mitat Kondi, Nimet Velu, Neshat Kondi, Hariz Shalari, ...Neshat Kasi, Hajro Skreli, ... Në çetë kishin ardhur më vonë edhe nga Rrëzoma e Delvinës. Çeta partizane e krahinës së Kardhiqit që në ditën e parë të krijimit shkoi në Senicë dhe çarmatosi postën e Senicës dhe më tej vijoi në Fushëvërrin, Vergo, Kopacez, Palavli, Lefterhor, Varfaj, Kakodhiq, Bajkaj, Ura e Shijanit. Çeta u shtua dhe u forcua. Ajo vetëm në një javë aktivitet ngriti njësitet guerile dhe këshillat nacionalçlirimtare në çdo fshat, hapën depot e kazermave dhe shpërndanë drithin për të shuar urinë e zisë së popullsisë së kësaj treve patriotike, prenë telat telefonike e telegrafike në disa pika në Stjar në afërsi të Delvinës dhe Sarandës. Bujq e blegtorë u bënë bashkë dhe panë me sytë e tyre se çfarë ishte formacioni partizan i çetës që punonte për popullin. Kthimi në bazë në Fushëbardhë dhe në fshatrat e tjera të krahinës solli dritë e shpresë në të gjithë krahinën. Nga xhandarmëria filluan dezertimet. Çeta raportonte në bazë për sukseset e saj dhe për ndjenjën e dashurinë masive popullore ndaj saj.

Figura të rëndësishme të si Mustafa Matohiti, Haki Toska, Sai Tare nga Nivica, Selman Lame nga Kuçi, Zini Sako, etj., vlerësuan punën e drejtuesve të çetës dhe mbarë çetës të “Çakallit” (Dilaver Poçit) dhe “Ustait” (Gani Haloçit). Çeta labe e krahinës së Kardhiqit ishte gjithmonë në veprim dhe në aksione të pandërprera, ndërkohë që rritej dhe forcohej. Viti 1943 filloi me një aktivitet edhe më të dendur të çetës në luftë kundër fashizmit në Urën e Kardhiqit, në kodrat

e Humelicës, në rrugën automobilistike Viroi - Shkalla e Zezë; më 9 janar 1943 kapi dhe çarmatosi një patrullë milicie në fushën e Mashkullorës. Një grup i çetës u dërgua për të marrë pjesë në luftimet e Gjormit në Vlorë, që filluan në ditët e para të janarit 1943 nga populli e çetat e Mesaplikut. Çeta në mes-janari 1943 veproi energjikisht në zonën e Delvinës dhe Konispolit; ngriti këshillat nacionalçlirimtare në Rusan, Krane, Finiq, Stjar, Durmish, etj.; kontrollonte

● *Gani Haloçi ishte dhe ngeli usta i halleve të popullit, u trupëzua njësh me popullin dhe në momentet historike, kur në vatrat shqiptare kishte pllakosur zija e pushtimit ai u bë misionar i lirisë dhe çlirimit.*

rrugën Delvinë-Konispol; kaloi Bistricën dhe sulmoi postën e xhandarmërisë në Aliko, duke i shpartalluar ata, goditi një autokolonë armike, ju rrëmbeu karvanët hajdutëve dhe kthyen rreth 50 kafshë të ngarkuara “gjoja për partizanët”, ku u gjykuan para popullit 7 veta nga gjyqi i çetës partizane. Ndërkohë si rezultat i veprimeve të çetës posta e Sopikut u detyrua të dorëzohej çetës partizane. Ura e Bistricës dhe pothuaj postat kufitare ishin të gjitha në zotërim të çetës partizane të krahinës së Kardhiqit. Është për t’u shënuar një aksion shumë i suksesshëm i Zminecit, që ishte tipik partizan me sulm të befasishtëm, ku u çarmatosën 28 ushtarë kufitarë, ndërkohë që në luftimet e 17-18 shkurtit 1943 në brezin kufitar Karoq-Leshnicë e sipërme pati të vrarë, 34 robër, 37 pushtë, 2 mitraloza të lehtë “Breda”, një mitraloz i rëndë “Fiat”, 5 revolvera, mbi 6000 fishekë, 80 bomba, 45 complete e mjaft materiale.

Çeta u shndërrua në një uragan dhe u bë më se e njohur për ndihmesën që i dha popullsisë edhe në Finiq, e cila i hapi dyert dhe zemrat partizanëve. Tre inkursionet në zonën e Delvinës, Sarandës e Konispolit shkruan histori suksesi të luftës. Edhe fshatrat përreth në Rumanxa, Senicë, Leshnicë, Dushnik, Pandalejmon, Kulluricë shpërndanë kudo drithë dhe shpresë. Pagëzimi i çetës u bë pasi kaloi provën e zjarrit. Më 27 mars 1943, çeta mori emrin e patriotit dhe luftëtarit të rilindjes kombëtare “Çerçiz Topulli”, një emër i merituar plotësisht. Emrin e ri të çetës e prezantoi i deleguari i Komitetit të Partisë të Qarkut të Gjirokastrës, Shefqet Peçi, por çeta e zgjeruar me rreth 80 partizanë kishte mbërritur në fshatin Prongji. Pas dy ditësh, më 29 mars 1943, çeta u mbledh sërish në Fushëbardhë dhe prej andej përreth tre javë shkoi në fshatrat e Vurgut, në Shalës, Dishat, Markat, Sopik, Vagalat, Hadër-Aga si dhe në zonën e Konispolit, ku bashkëpunoi me çetën “Çamëria”. Ndërkohë në çetë kishin shkuar dhe Adil Çarçani, Demo Fejzo, Sejdi Hoxhalli, Haxhi Doraci e dhjetëra të tjerë. Aksionet pas Rrëzomës, Vurgut e Konispolit vijuan në krahinën e Kardhiqit, Koronë, Kolonjë, Golem, fusha e Kardhiqit, qafa e Taroninës, Zhulat, Kapariel, ndërkohë që mbledhja e Rehovës, më 28 prill 1943, e ndau “shapin nga sheqeri” ndërmjet organizatave që ishin hedhur në frontin e luftës, por me

ide dhe konceptim krejt të kundërt për mënyrën e luftimit të pushtuesve. Përballë Ali Bej Këlcyrës, Dervish Rexhepit, Ismail Golemit, Xhevat Kallanxhiut, Qemal Shtinos, u vendosën Subi Bakiri, Shefqet Peçi, Adil Çarçani, Siri Çarçani, Sheri Baboçi, Haxhi Progonati, Demo Fejzo, Bajram Sinoimeri. Aktiviteti i çetës vijoi edhe përgjatë Drinos, Labovë e Kryqit, Palokastër, Labovë, Suhë, Hormovë, Gërhot, Çepunë, Subash etj. Misioni i Çetës partizane “Çerçiz Topulli”, mbeti

emblemë heroizmi dhe besnikërie të idealeve të lirisë prandaj mbeti edhe emërndritur në historinë e LANÇ-it, pasi ajo në ditën e krijimit të batalionit partizan “Asim Zeneli”, më 7 gusht 1943, tek rrapet e Kardhiqit u bë një ndër formacionet që i dhanë jetë veprimtarisë së batalionit të lavdishëm partizan, që mbante emrin e heroit dhe dëshmorit “Asim Zeneli”.

Gani Haloçi ishte tashmë më i rritur dhe me eksperiencë në luftime, ndaj edhe kënga e tij gjëmoi në të dy brigjet e lumit Belica të krahinës së Kardhiqit: “O Cepo, moj ballëllartë,/Të mbiu lufta në prag,/ Luftë ditë e luftë natë”.

● **Burri që rrezatonte urtësi, mirësi dhe besim**

Gani Haloçin e njohin dhe gurët e rrugës për urtësinë, mirësinë njerëzore dhe besimin në idealet patriotike e atdhetare. Ai punoi dhe jetoj plot nder dhe dinjitet. Shërbeu me vetëmohim në detyra me rëndësi pas luftës antifashiste dhe çlirimit, atje ku kishte nevojë atdheu. Bazë

nevojë të humlutojë thellë në arkiva, sepse me kompetencën e një historiani dëshmitar në jetë e në luftë, në punë e forume ka sjellë vetë dimensionin e një njeriut të thjeshtë e punëtor, dimensionin e një shembullori, që nuk ka nevojë për asnjë dafinë për jetën e tij reale dhe të mbushur plot jetë e aktivitet. Në rreshtat ku thotë “gjurmët e jetës time...”, ka eliminuar fjalën “unë” me fjalën “neve”, dhe këtë e ka dokumentuar me firmën e tij, sepse ai përgjatë gjithë jetës luftoi dhe punoi me

miq dhe me shokë. Ai nuk shkroi thjeshtë një libër, por ngriti një memorial që e përjetësoi jetën e gjithë Prongjisë, të Krahinës së Kardhiqit. Ai përjetësoi të vërtetat e mëdha të çetës “Çerçiz Topulli”, të vend themelimit, në Fushëbardhë dhe të vendit ku iu dha emri kësaj çete, në Prongji. Ai flet me data dhe është i prerë dhe fjalën e ka të larë me dritën e diellit, që nuk lë shtigje për shtrembërime e rregullime, sepse ai ishte vetë arkivi dhe ditarshkruesi i veprimtarisë së çetës së parë partizane të Krahinës së Kardhiqit, por dhe i formacioneve të tjera partizane të ngritura në këtë krahinë si: më 12.12.1942 krijohet në Fushëbardhë çeta partizane “Çerçiz Topulli”; më 7.8.1943 krijohet tek rrapet e Kardhiqit e Prongjisë batalioni partizan “Asim Zeneli”; më 12.12.1943 krijohet në Fushëbardhë batalioni “Abaz Shehu”; në dhjetor 1943 krijohet në Fushëbardhë batalioni i rinisë i krahinës së Kardhiqit; në janar 1944 krijohet në Fushëbardhë Grupi i Parë partizan me dy batalione; në prill-tetor 1944 në Fushëbardhë ka

partizan “Asim Zeneli”, batalioni “Abaz Shehu”, Grupi i Kurveleshit, Grupi “Çamëria”, ndërsa nga Brigadat partizane në krahinë e Kardhiqit janë mirëpritur formacionet partizane të: Br1S; Br.IIIS, Br.VS, BrVIS, Br.VIIS, BrXIVS. Lapidari i 540 partizanëve të batalionit “Asim Zeneli” flet qartë edhe për gjakun e 104 dëshmorëve të kësaj krahine lavdiplotë, që përfaqësonin pushkët e luftëtarëve të gjithë krahinës së Kardhiqit, që i bënë nder Labërisë, Gjirokastrës dhe mbarë truallit shqiptar. Të gjitha këto të dhëna vijnë përmes shënimesh të luftëtarit, partizanit dhe kuadrit të lartë ushtarak, Gani Haloçi, që në fakt i bën nder historiografisë shqiptare dhe veçanërisht asaj ushtarake. Ai nuk mbahej kurrë “në të madh e të rëndë”, sepse pikëpamja e tij ishte më se njerëzore: “Madhështinë e njeriut nuk e bëjnë postet e larta që arrin në detyrë, por virtytet, karakteri i tij, ideali atdhetar, familja, të cilave u përkushtohesh”. Ai gjatë karrierës ushtarake është vlerësuar me tetë dekorata të të gjithë niveleve, përfshi dhe vlerësimet me dekorata si medalja e kujtimit, e trimërisë, Urdhrin e Skënderbeut, vlerësime nga Këshilli i komunës, si “Krenari e Komunës së Cepos”, me vendim nr. 31 datë 22.05.2003, “Si atdhetar, patriot dhe pjesëmarrës aktiv i lëvizjes nacionalçlirimtare”. SHKA “Labëria” ka vendosur të nderojë me “Mirënjohje të Labërisë”, këtë figurë madhore të Labërisë, që iu priu formacioneve partizane, por edhe të ushtarakut madhor që ka shkëlqyer denjësisht në karrierë, në shërbim të Atdheut.

Gani Haloçi është vlerë shembullore e luftës, e punës dhe e jetës, por edhe e veprimtarisë qytetare, shoqërore e familjare, për të gjithë etapat e jetës së tij ndriçon fort ndershmëria e përkushtimi ndaj vendit. Për këtë arsye meriton të nderohet thellësisht për dimensionin vital dhe rrezatimin që bëri në veprimtarinë e tij, në emër të misionit si luftëtar dhe si ushtarak i denjë, si patriot dhe

● *Kundërshtimi i pushtimit ishte një revoltë e brendshme e popullit. Gani Haloçi ishte ndër të parët në Prongji dhe krahinë që filloi punën e organizuar për ngritjen e popullit në Luftën antifashiste, që në mars 1942, kur me vendim të komitetit qarkor të Gjirokastrës, Dilaver Poçi transferohet nga Saranda në Krahinën e Kardhiqit si organizator kryesor. Rrugët e atdhetarëve të flaktë bashkoheshin në ideale të mëdha antifashiste.*

e jetës së tij ishte “nderi-detyra-atdheu”, ndërkohë që ishte një familjar shembullor, i admiruar në jetën shoqërore si qytetar dhe ushtarak shembullor. Kushdo që merr penën për të shkruar për Gani Haloçin e ka të lehtë sepse ai e vetëshkroi jetën e tij dhe la një libër-vlerë “Jeta ime”, që është publikuar në vitin 2009, “me rastin e njëqindvjetorit të lindjes”, por nga ana tjetër e ka edhe të vështirë sepse duhet të matë fjalët për saktësinë dhe kronologjinë e ngjarjeve, sepse është e pamundur të anashkalosh dhe të “dalësh nga shinat”, sepse jeta e tij është e mbushur plot me vlera të spikatura të luftës, të punës dhe të jetës qytetare e familjare. Ai nuk ka pasur

vepruar Komanda partizane e vendit. Në çdo fshat të krahinës së Kardhiqit kishte çeta territoriale, depo armësh, depo ushqimi, furrë buke spital partizan, ndërldhje telefonike me Cepen, Senicën, Shtabin e Zonës së Parë Operative Poliçan. Ndërkohë që në tetor 1944, populli i krahinës së Kardhiqit i mbledhur në Fushëbardhë i dërgon një telegram përshëndetjeje qeverisë së Beratit. Në vitin 1942 në fshatrat e krahinës së Kardhiqit janë prituri çetat partizane si më poshtë: çeta “Çerçiz Topulli”, çeta “Hajredin Tremishti”, çeta “Avni Rustemi”, çeta “Koto Hoxhi”, çeta “e Bregut”, çeta e Çamërisë; në vitet 1943-1944 batalioni

intelektual. Ai ishte dhe mbeti deri në fund të jetës njeri i drejtë, me kulturë të gjerë, i butë, i arsyeshëm e tolerant, që rriti bashkë me bashkëshorten e tij, shtatë fëmijë, në një fole të ngrohtë mirësie e dashurie njerëzore, që vijuan bindshëm rrugën e prindërve të tyre të mirë. Mirënjohje, homazh dhe përjetësi për burrat që shkruan histori dhe vunë gjithçka në dispozicion të vendit dhe krejt shqiptarizms. Mirënjohje dhe homazh për ish-nënkoloneln Gani Haloçi, që nuk vrapoi kurrë pas lavdisë, por eci thjesht dhe me guxim në jetë, duke rrezatuar urtësi, mençuri, përkushtim ndaj familjes, shoqërisë dhe atdheut.

Grupi për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit të KESE-së mbajti një dëgjim publik për mbrojtjen e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese të grave. Pjesëmarrësit në debat kërkuar shërbime shëndetësore falas, akses në kontracëpsion, politika më gjithëpërfshirëse dhe edukim riprodhues dhe seksual. Ky debat u organizua në bashkëpunim me Grupin e Barazisë së KESE-së, si pjesë e një sërë ngjarjesh të KESE-së në vijim të nismës së Javës së Barazisë Gjinore të Parlamentit European.

Zhvillimet e fundit kanë treguar se të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave nuk janë të pakthyeshme. Kjo ka çuar në rezultate katastrofike për gratë që mund të privohen nga zgjedhja e tyre e lirë dhe e informuar, dhe në veçanti ato që jetojnë në varfëri dhe janë të marginalizuara për arsye të ndryshme.

Maria Nikolopoulou, presidente e Grupit të Barazisë së KESE-së, hapi dëgjuesën publike: Debat i mbi rolin e grave po bëhet më i nxehtë. “Disa çështje që menduam se do të zgjidheshin po vihen sërish në pikëpyetje dhe po kërcënohen të drejtat e konsoliduara. Ne nuk mund të rrimë duar dhe të zhytemi në zemërim dhe zhgënjim, ne duhet të mobilizojmë shoqërinë për të promovuar edukimin seksual dhe riprodhues”. Caroline Hickson, Drejtore të Rajonale për Evropën e Federatës Ndërkombëtare të Prindërimit të Planifikuar (IPPF), shpjegoi rrënjën e këtij reagimi ndaj të drejtave të grave: Ekziston një lëvizje që i refuzon këto vlera dhe dëshiron të ruajë status quo-në e pushtetit dhe privilegjit të ndaluar nga patriarkali. shoqërinë. Ata i shtrembërojnë qëllimisht termat si barazia gjinore për të nxitur projektet e tyre politike, por objektivat e tyre janë shumë më të gjera: është një sulm ndaj demokracisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës. Të drejtat e grave janë fushëbeteja ku po zhvillohet beteja kundër demokracisë dhe sundimit të ligjit. BE-ja duhet të ngrihet për të mbrojtur këto të drejta.

Barriera më e madhe për të drejtat seksuale dhe riprodhuese janë diskriminimi gjinor dhe normat sociale, shpjegoi Birgit Van Hout, Drejtore e Zyrës së BE-së të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA). Ajo bëri thirrje për më shumë gra në udhëheqje, mbështetje për mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave, avancimin e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm, tejkallimin e hendekut midis ligjit dhe praktikës dhe integrimin e të drejtave të grave në arsim.

Seanca dëgjimore mbledhi pikëpamjet e shoqërisë civile mbi zhvillimet aktuale në të drejtat riprodhuese të grave. Aline Brüser nga Konfederata Evropiane e Sindikatave (ETUC), theksoi se menstruacionet, menopauza, shtatzënia dhe qasja në kujdes janë gjithashtu çështje në vendin e punës. Ana Peláez Narváez, nga Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar (EDF), tregoi vështirësitë me të cilat përballen veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara dhe u bëri thirrje Shteteve Anëtare të BE-së që ende autorizojnë sterilizimin e detyruar të personave me aftësi të kufizuara që të ndalojnë këtë praktikë. Deekshitha Ganesan, nga Evropa Transgjinore (TGEU), theksoi nevojën për një qasje ndërsektoriale dhe shpjegoi se si disa praktika të kujdesit shëndetësor po shkelin të drejtën për akses të barabartë në kujdes dhe dinjitetin njerëzor për shumë në komunitetin LGBTIQ+. Së fundi, Bekky Ashmore, nga Plan International UK, dhe Beatriz

Ne të gjithë duhet të jemi feministë për të luftuar për të drejtat e të gjitha qenieve njerëzore



Rótolí, nga Rrjeti Evropian i Rinisë për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese (YouAct), theksuan realitetin e shumë vajzave të reja dhe të rinjve të rritur që përballen me diskriminimin e dyfishtë të moshës dhe gjinisë, dhe Emilie. Jarrett dhe Cynthia Karanja, nga Rrjeti Evropian i End Female Genital Mutilation (FGM), shpjeguan se si 190.000 vajza dhe gra rrezikoheshin t'i nënshtroheshin praktikës së dëmshme në Evropë.

Në mbyllje të aktivitetit, José Antonio Moreno Díaz, Raportues i opinionit të KESE-së për Luftën kundër dhunës ndaj grave, nënvizoi se mekanizmi historik i dominimit mbi gratë është kudo, në kulturë, ekonomi dhe shoqëri në tërësi. Ky është një element sistematik i represionit, është një luftë kulturore. Ne të gjithë duhet të jemi feministë për të luftuar për të drejtat e të gjitha qenieve njerëzore.

EMA rekomandon tërheqjen e barnave folkodinike nga tregu i BE-së

Komiteti i sigurisë i EMA-s, PRAC, ka përfunduar rishikimin e barnave që përmbajnë folkodinë, të cilat përdoren tek të rriturit dhe fëmijët për trajtimin e kollës joproductive (të thatë) dhe, në kombinim me substanca të tjera aktive, për trajtimin e simptomave të ftohjes dhe gripit. dhe ka rekomanduar revokimin e autorizimeve të marketingut të BE-së për këto barna.

Gjatë rishikimit, PRAC vlerësoi të gjitha provat e disponueshme, duke përfshirë rezultatet përfundimtare të studimit ALPHO, të dhënat e sigurisë pas marketingut dhe informacionin e paraqitur nga palë të treta si profesionistët e kujdesit shëndetësor. Të dhënat e disponueshme treguan se përdorimi i folkodinës në 12 muajt para anestezisë së përgjithshme me agjentë bllokues neuromuskular (NMBA) është një faktor rreziku për zhvillimin e një reaksioni anafilaktik (një reaksion alergjik i papritur, i rëndë dhe kërcënues për jetën) ndaj NMBA.

Meqenëse nuk ishte e mundur të identifikoheshin masa efektive për të minimizuar këtë rrezik, as të identifikoheshin një popullatë pacientësh për të cilët përfitimet e folkodinës tejkalojnë rreziqet e saj, ilaçet që përmbajnë folkodinë po tërhiqen nga tregu i BE-së dhe për këtë arsye nuk do të jenë më të disponueshme me recetë ose pa recetë.

Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të marrin në konsideratë alternativat e duhura të trajtimit dhe t'i këshillojnë pacientët të ndalojnë marrjen e barnave që përmbajnë folkodinë. Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet gjithashtu të kontrollojnë nëse pacientët e planifikuar t'i nënshtrohen anestezisë së përgjithshme me NMBA kanë përdorur folkodinë në 12 muajt e mëparshëm dhe të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e reaksioneve anafilaktike në këta pacientë. Një studim i kohëve të fundit tregoi se përdorimi i barnave që përmbajnë folkodinë, të cilat përdoren për trajtimin e kollës së thatë tek të rriturit dhe fëmijët, lidhet me rrezikun e reaksioneve anafilaktike (një reaksion alergjik i papritur, i rëndë dhe kërcënues për jetën) ndaj disa ilaçeve të quajtur bllokimi neuromuskular, agjentët (NMBA) që përdoren në anestezitë të përgjithshme. Duke qenë se nuk janë identifikuar masa efektive për të minimizuar këtë rrezik, ilaçet folkodinike po tërhiqen nga tregu i BE-së. Pholcodine është një ilaç opioid që përdoret tek të rriturit dhe fëmijët për trajtimin e kollës joproductive (të thatë) dhe, në kombinim me substanca të tjera aktive, për trajtimin e simptomave të ftohjes dhe gripit. Punon drejtpërdrejt në tru, duke shtypur refleksin e kollës duke reduktuar sinjalet nervore që dërgohen në muskujt e përfshirë në kollë. Pholcodina është përdorur si frenues i kollës që nga vitet 1950. Në BE, ilaçet që përmbajnë folkodinë janë aktualisht të autorizuar në Belgjikë, Kroaci, Francë, Irlandë, Lituanë, Luksemburg dhe Slloveni, ose me recetë mjekësore ose si ilaç pa recetë. Ato shpesh përmbajnë folkodinë në kombinim me substanca të tjera dhe disponohen si shurupe, solucionet orale dhe kapsula me emra të ndryshëm tregtarë dhe si gjenerikë. Pholcodine tregtohet me emra të ndryshëm duke përfshirë Dimetan, Bicalyptol dhe Broncalene.



SHPYLLËZIMI DHE DEGRADIMI I PYJEVE I NËXITUR NGA PRODHIMI DHE KONSUMI I BE-së

Marrëveshja për ligjin e ri: Produktet që shkaktojnë shpyllëzim të mos shiten në BE

- Një zonë më e madhe se BE-ja humbi për shkak të shpyllëzimit nga viti 1990 deri në vitin 2020, me konsumin e BE-së që shkaktoi rreth 10% të humbjeve

- Gjerdhët, kakaoja, kafeja, vaji i palmës, soja, druri, goma, qymyr dhe produktet e letrës së shtypur mbulohen nga rregullat e reja

- Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e vendasve u shtuan si kërkesa shtesë

- Për të luftuar ndryshimet klimatike dhe humbjen e biodiversitetit, ligji i ri detyron kompanitë të sigurojnë që një sërë produktesh të shitura në BE të mos vijnë nga toka të shpyllëzuara askund në botë.

Eurodeputetët arritën një marrëveshje paraprake me qeveritë e BE-së për një ligj të ri për produktet pa shpyllëzim, i cili do ta bëjë të detyrueshëm për kompanitë të verifikojnë dhe lëshojnë një deklaratë të ashtuquajtur “due diligence”, që mallrat e vendosura në tregun e BE-së nuk kanë çuar në shpyllëzim dhe degradim të pyjeve kudo në botë pas 31 dhjetorit 2020. Sipas tekstit të rënë dakord, ndërsa asnjë vend apo mall si i tillë nuk do të ndalohet, kompanitë nuk do të lejohen të shesin produktet e tyre në BE pa këtë lloj deklarate. Siç kërkohet nga eurodeputetët, kompanitë do të duhet gjithashtu të verifikojnë pajtueshmërinë me legjislacionin përkatës të vendit të prodhimit, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe se të drejtat e



njerëzve indigjenë të interesuar janë respektuar.

Ligji i ri do t'u garantonte konsumatorëve evropianë që produktet që ata blejnë nuk kontribuojnë në shkatërrimin dhe degradimin e pyjeve, duke përfshirë pyjet parësore të pazëvendësueshme, dhe kështu do të reduktonte kontributin e BE-së në ndryshimet klimatike dhe humbjen e biodiversitetit në nivel global.

Produktet që mbulohen nga legjislacioni i ri janë: bagëtia, kakaoja, kafeja, vaji i palmës, soja dhe druri, duke përfshirë produktet që përmbajnë, janë ushqyer ose janë bërë duke përdorur këto mallra (të tilla si lëkura, çokollata dhe mobili), si në propozimin origjinal të Komisionit. Gjatë bisedimeve, eurodeputetët shtuan me sukses: gomë, qymyr, produkte letre të shtypura dhe një numër derivatesh të vajit të palmës. Parlamenti siguroi gjithashtu një përkufizim më të gjerë të degradimit të pyjeve që përfshin shndërrimin e pyjeve parësore ose pyjeve të rigjenerimit natyror në pyje plantacionesh ose në tokë të tjera pyjore dhe shndërrimin e pyjeve parësore në pyje të mbjella.

Komisioni do të vlerësojë jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi, nëse do të zgjerohet fushëveprimin në toka të tjera pyjore. Jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi, Komisioni do të vlerësojë gjithashtu një shtrirje të fushës së veprimit në ekosistemet e tjera, duke përfshirë tokën me rezerva të larta karboni dhe me një vlerë të lartë biodiversiteti, si dhe në mallra të tjera. Në të njëjtën kohë, Komisioni do të vlerësojë gjithashtu nevojën për të detyruar institucionet financiare të BE-së që të ofrojnë shërbime financiare për klientët e tyre vetëm nëse vlerësojnë se ekziston vetëm një rrezik i papërfillshëm që këto shërbime të mos çojnë në shpyllëzim.

Epoka e platformave të trajnimit me shumë domene

Ndërsa operacionet ushtarake evoluojnë në zonën gri, operacionet kibernetike dhe me shumë domene, konceptet dhe sistemet e trajnimit gjithashtu duhet të avancojnë në mënyrë që të përgatisin operatorët për fushat e betejës së së ardhmes. Mjegullimi i botëve fizike dhe dixhitale po krijon një ekosistem të ngjashëm me një metaverse ushtarake që do të ftojë një bashkëpunim më të ngushtë. Nick Brown, drejtor i marketingut dhe zhvillimit të biznesit Hadean – i Mbrojtjes, Lee Shearer, kreu i zhvillimit të biznesit PLEXSYS, MB, Evropë dhe Lindjen e Mesme, dhe David Head, kreu i partneriteteve strategjike të Thales, shqyrtojnë se si sistemet e trajnimit me shumë domene mund të ndikojnë në sektorin e mbrojtjes në të ardhmen.

Ushtritë moderne po përballen me kërcënime të paprecedentë në një mjedis operativ në zhvillim që kërkon gatishmëri të vazhdueshme. Rritja e luftës hibride i ka shtyrë forcat e armatosura moderne të rivlerësojnë pragjet e njohura të konfliktit, ndërkohë që domenet në zhvillim, si hapësira dhe kibernetika, kanë krijuar domosdoshmërinë për të zhvilluar fije të avancuara të doktrinës ushtarake dhe kërkesave që i japin një kuptim të ri operacioneve të kombinuara të armëve.

Kohët e fundit, nevoja për të mbrojtur infrastrukturën kritike është theksuar gjithashtu, pasi miliona shtëpi, biznese dhe shërbime janë prekur nga sulmet në tubacionet e gazit nëndetëse dhe termocentralet e energjisë si rezultat i luftës në Evropën Lindore. Kjo ka rritur rëndësinë e gatishmërisë ushtarake dhe vendimmarrjes së shpejtë, të bazuar në të dhëna për skenarët e mundshëm dhe efektet e tyre të përhapjes përtej fushëbetesës.

E gjithë kjo është vendosur në një sfond të tendencave makro teknologjike që krijojnë mundësi të reja, si dhe pasiguri dhe kërcënim. Teknologjitë dixhitale e shtojnë dhe mbështesin gjithnjë e më shumë aktivitetin tonë në botën reale; mënyra se si qeveritë e menaxhojnë këtë turbullim të asaj fizike dhe virtuale nëpër rrjete gjithnjë e më komplekse do të jetë çelësi i suksesit ose dështimit. Kjo zbatohet gjithashtu për përvojën e përdoruesit të ushtarëve, pilotëve dhe marinarëve që kanë nevojë për një mënyrë të qëndrueshme, intuitive dhe të aksesueshme për të aksesuar informacionin, për të mbështetur vendime të mira dhe të shpejta dhe për të parandaluar gabimet. Pasojat e shpërndarjes së gabuar të burimeve ose dështimit të navigimit, për shembull, mund të jenë të rënda në një mjedis operativ të drejtpërdrejtë. Pikërisht në këto rrethana ne kemi filluar të shohim të shfaqet nocioni i një “metaverse ushtarake”.

Mjedise të izoluar trajnimi

Për 20 vitet e fundit, simulimet specifike të trajnimit në domen u kanë dhënë udhëheqësve të qeverisë dhe ushtarakëve aftësinë për t’u trajnuar për situata të botës reale dhe për të zhvilluar aftësitë dhe taktikat më të përshtatshme për rezultatet pozitive që duhen arritur. Për shembull, pilotët luftarakë janë në gjendje të praktikojnë manovra në simulimet stërvitore që përdorin një kombinim të realitetit të shtuar, AI dhe motorëve interaktivë të lojës.

Megjithatë, ndërkohë që bota fizike vazhdon të bëhet gjithnjë e më komplekse, kufizimet teknike të infrastrukturës së llogaritjes së trashëguar kanë vendosur, deri më tani, një kufi të vështirë për atë që mund të arrihet me simulatorët e drejtpërdrejtë, virtuale dhe konstruktivë (LVC). Ndërsa përfitimet e simulimeve zhytëse dhe me ndikim për të ndihmuar në trajnimin e ushtarëve, marinarëve dhe pilotëve janë të mëdha, sistemet aktuale ndërtohen dhe përdoren të izoluar nga njëri-tjetri, duke kufizuar potencialin e tyre për rritjen e shkallës, lidhjes dhe ndërveprimit.

Pa sinkronizim në kohë reale, trajnimi sintetik nuk është në gjendje të pasqyrojë ndërlidhjet e mjedisit të sotëm kompleks operativ ku veprimi në të gjithë domenet ushtarake zhvillohet njëkohësisht.

Pa fuqinë llogaritëse të nevojshme për të shkurtuar një fluks të dhënash dhe informacioni, trajnerët sintetikë të fragmentuar janë gjithashtu të kufizuar në aftësinë e tyre për të ushqyer në mënyrë



dinamike të dhëna për analitikë dhe mbështetje vendimesh. Si rezultat, ushtrime në terren në shkallë të gjerë, të shtrenjta dhe komplekse logjistike përdoren për të kompensuar mungesën e trajnimit sintetik të vetëm me shumë fusha.

Konvergenca e virtuale dhe asaj fizike

Nuk është më e pranueshme që këto ushtrime të zhvillohen të izoluar. Bota po ndryshon dhe shprehja e vjetër “përshat ose vdis” lind në mendje; vazhdimi i një qasjeje të heshtur vetëm do të krijojë pengesa për bashkëpunimin dhe do të kufizojë aftësinë e ushtrisë për të kryer në mënyrë efektive ushtrime dhe trajnime të përbashkëta; trajnim që vërtet mbështet integrimin me shumë domene.

Kthimi drejt kornizave teknike më të decentralizuara do të na lejojë të sjellim idetë, të dhënat dhe simulimet nën një çati. Ideja e një metaverse ushtarake është abstrakte, por shërben si një përshkrues që përmbledh ekosistemin e teknologjive që na lejojnë të bashkojmë fusha dhe aktivitete të ndryshme në një hapësirë të vetme virtuale. Mjediset e vetme sintetike janë ndër rastet e para të kësaj teknologjie që përfshihet në gjuhën ushtarake. Këto simulime të federuara të trajnimit lejojnë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë nëpër fusha dhe madje edhe organizata heterogjene si NATO.

Një ndryshim në doktrinën e trajnimit ushtarak

Rrjedhimisht, udhëheqësit ushtarakë dhe qeveritarë kanë kërkuar të formojnë kohezion të gjerë ushtarak rreth një shtylle thelbësore të teknologjive dixhitale që mund të ndihmojnë për të arritur gatishmërinë dhe optimizimin në operacione, nga trajnimi dhe lojërat luftarake deri të analiza e të dhënave të drejtpërdrejta dhe mbështetja e vendimeve. Vizioni për përdorimin e mjediseve sintetike në ushtritë moderne është përshkallëzuar nga simulimet specifike të fushës dhe skenarit në një përzjerje të trajnimit LVC

që do të lejojë aktorët nga fusha të ndryshme të trajnohen dhe të bashkëpunojnë së bashku në të gjitha klasifikimet në një mjedis të vetëm sintetik gjithëpërfshirës dhe me besnikëri të lartë.

Nuk duhet kërkuar larg për të kuptuar se forcat e armatosura janë të vetëdijshme për nevojën për këtë rrugë bashkëpunuese. Duke demonstruar një qasje për të ardhmen, po zhvillohen programe ambicioze për të shfrytëzuar mundësitë e mjediseve të përziera fizike/virtuale të shkallëzueshme dhe të integruara dhe për të ofruar trajnime realiste dhe të përsëritshme.

Është e qartë se teknologjitë dhe aplikacionet e platformës që mbështesin lojërat në internet dhe metaverset janë të njëjta që do të sjellin nivelin tjetër të epërsisë ushtarake.

Në Mbretërinë e Bashkuar, programe si Kapaciteti i Trajnimit Operacional i Mbrojtjes (Detare) dhe Trajneri i Komandës dhe Stafit

Detar janë fokusuar në mundësimin e ndërveprimit të simulimeve për të lidhur anijet dhe sistemin e bazuar në breg dhe për të modernizuar ofrimin e trajnimit të Marinës Mbretërore. Programi i Gladiatorit të Forcave Ajrore Mbretërore është një tjetër përpjekje që kërkon të përmirësojë besnikërinë dhe kompleksitetin e trajnimit të pilotëve nga simulatorët e rrjetit të vendosur në vende të ndryshme për të shumëfishuar efektin e stërvitjes dhe për të përshpejtuar përgatitjen e forcës.

Në fushën e tokës, Programi i Transformimit të Trajnimit Kolektiv po transformon mënyrën se si ushtarët stërviten së bashku, duke federuar sisteme për të përfshirë luftën me shumë domene, duke bërë jehonë të skenarëve të botës reale me besueshmëri të lartë dhe për të mundësuar shfrytëzimin e kapjes së të dhënave në përputhje me fokusin më të gjerë të Mbrojtjes në trajnime të bazuara në të dhëna dhe vendimmarrje.

Rruga përpara


Arritja e integritimit ndërmjet sistemeve paraqet një sfidë të menaxhimit dhe shpërndarjes së të dhënave me sisteme të ndryshme që kërkojnë konsolidim kompleks. Një sasi e madhe e fuqisë llogaritëse është thelbësore, së pari; për të menaxhuar numrin dhe madhësinë masive të subjekteve ndërvepruese dhe së dyti; për të lundruar në rrjetin e ndërlikuar që vjen me konvergimin e pikave të shumta të të dhënave nga vende të ndryshme. Ndërsa janë ende në një fazë eksperimentale, të gjitha këto ndërhyrje stërvitore me performancë të lartë dhe të tjerat që do të vijnë, të cilat do të përdoren për të formuar një metaverse ushtarake plotësisht të mishëruar, do të furnizohen vetëm nëpërmjet fuqisë së kombinuar të informatikës cloud të shpërndarë, simulimeve me shumë domene me cilësi të lartë dhe teknologjisë AI.

Koncepti i një metaverse ushtarake të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me performancë të lartë do të nxisë bashkëpunimin. Kompleksiteti i sfidave teknike, kërkesa për të ofruar zgjidhje që do t’i mbrojnë shërbimet e armatosura në të ardhmen dhe do të sigurojnë ruajtjen e avantazhit konkurrues përpara kundërshtarëve do të kërkojnë një qasje të përbashkët. Do të duhet të ketë një konglomerat midis kompanive komerciale, akademisë dhe ushtrive që punojnë së bashku brenda ekosistemeve të teknologjive të ndërveprueshme.

Ku po shkon e ardhmja e trajnimit të mbrojtjes?

Metaversi, të cilin ne e përcaktojmë këtu si një hapësirë në të cilën bota fizike dhe dixhitale ndërveprojnë për të rritur kuptimin dhe përvojën tonë të botës reale, në të ardhmen e afërt do të ketë një ndikim shumë real në jetën civile dhe mënyrat se si ne komunikojmë. Mësojmë, socializojmë dhe strukturojmë ekonominë tona. Ushtria do të duhet të ndryshojë mendimin e saj për t’u lidhur me përparimet që po sjell Web 3.0.

Është e qartë se teknologjitë dhe aplikacionet e platformës që mbështesin lojërat në internet dhe metaverset janë të njëjtat që do të çojnë në nivelin tjetër të epërsisë ushtarake, duke nxitur inovacionin me një ritëm që do të plotësojë nevojat e kushteve globale që ndryshojnë me shpejtësi. Ekziston një lidhje midis botëve të mbrojtjes dhe metaverses, sepse brezat e ardhshëm do të jenë tashmë të njohur me këto platforma dhe trupat e së nesërme do të presin të stërviten në mjedise sintetike të vetme me shumë shtresa dhe shumë-disiplinore.



SHKOLLA USHTARAKE "SKËNDERBEJ"

Skënderbegasi Ahmet Shqarri, gazetari i njohur sportiv

Më 18 gusht të vitit 1953, mes gjimnazistëve që do të nisnin studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej" është dhe Ahmet Shqarri, sot, komentator i njohur sportiv në Shqipëri. Kjo shkollë, është vatra e parë ku spikati talenti dhe dashuria e tij për artin dhe sportin, pasione, të cilëve ai u bashkëngjiti punën dhe përkushtimin e palodhur në më shumë se katër dekada pa ndërprerë. Shqarri u lind në vitin 1939.

Zëri i Ahmet Shqarrit lakohet si transmetues i veçantë pasi solli shumë risi në emisionet sportive shqiptare, në të vetmen radio dhe televizion në hapësirat mbarë shqiptare për vite me radhë. Funksionimi i emisionit special "Nga njëra ndeshje në tjetrën", shënoi një hap cilësor të nivelit botëror për radio transmetimin shqiptar. Tek figura e Shqarrit, nuk ka spikatur vetëm zëri, por ambicia serioze për të hapur dritare të reja komunikimi me dëgjuesit, dritare, të cilat ruajnë dhe sot po atë shkëlqim dhe rrezatim në syrin dhe



veshin e dëgjuesit shqiptar.

Nëse paraardhësit e tij janë lakuar si ikonat e para të transmetimit, ai si vazhdues i tyre, e ngriti në pedestal emrin e komentatorit sportiv shqiptar, duke vulosur risi, që do të ngelen si shtatore të pazëvendësueshme. Mazreku, Bellova dhe Shqarri, do të mbeten një treshe simpatike, që hapën epokën e panjohur të transmetimit radiofonik, duke ia kaluar stafetën njëri-tjetrit, për t'u kthyer kështu në emblema që koha i ka përcjellë si figura referimi për të ardhmen e sportit shqiptar-dëgjues. Sipas Shqarrit, ka qenë një rastësi që u bë gazetar sportiv. Ka filluar të shkruajë kur ka qenë në shkollë të mesme. Në revistën "Shqiptarja e Re", botoi "Vajza e braktisur", i cili ishte një tregim... Krahast Fakultetit të Letërsisë, bëri edhe kursin dyvjeçar të gazetarisë, ku kishte pedagogë të tillë si: Vangjush Gambeta, Dritëro Agolli, Hamit Boriçi. Në sajë të tyre iu dha mundësia të shkruante në shtypin e

kohës si: "Zëri i Rinisë", "Puna", "Mësuesi", "Zëri i Popullit", "Bashkimi". Pra, ka qenë shumë i lidhur me librin. Bënte shumë përpjekje për të kapur librin sa dille në treg. Duke pasur një dëshirë të madhe për letërsinë, lexonte shumë. Kjo periudhë quhej periudhë prove. Ndërkohë që shkruante për gazeta të tjera, Ismet Bellova që ishte komentator dhe miku i tij, i ofroi të bashkëpunonte me të vetmen gazetë sportive të kohës "Sporti Popullor". Dy komentatorë ishin asokohe, Bellova dhe i madhi Anton Mazreku. Kur mbaroi studimet universitare, nuk kishte asnjë gazetar të diplomuar që të punonte për sportin në Radio-Televizion. Kështu, ai ishte i pari gazetar profesionist sportiv i një medie elektronike. Starti i karrierës ka qenë pikërisht gushti i vitit 1969, vit në të cilën u hodhën themelet për krijimin e Rubrikës Sportive të rregullt, që në fakt filloi në vitin 1970.

Shpend Topollaj, poeti, shkrimtari e publicisti i palodhur

Shpend Topollaj, është lindur më 14 shkurt të vitit 1947 në Berat. Babai i tij Hulësiu, partizan nga të parët, e më pas oficer, jurist dhe shkrimtar, ishte nga Novosela e Kolonjës, kurse e ëma, Hatixheja, ishte nga fisi i dëgjuar për atdhetari i Agallinjve në Vlorë. Fëmijërinë dhe rininë e ka kaluar në Shkodër dhe Tiranë. Sot, punon e banon në Durrës, prej afro pesëdhjetë vjetësh. Me të përfunduar shkollën shtatëvjeçare "Misto Mame", nis studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", të cilën e mbaron në vitin 1964. Më tej vazhdon shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1966 titullohet oficer këmbësorie. Emërohet në repartet e Durrësit, ku kryen detyra të ndryshme, si instruktor i stërvitjes me universitarët, shef i Stërvitjes së Brigadës së Katërt të Mbrojtjes Bregdetare, komandant batalioni. Por duke qenë se i ati i tij goditet rëndë, si bashkëpunëtor i "grupit puçist", me argumentin se kishte shkruar dhjetë vjet më parë një libër për luftën Nacionalçlirimtare, ku lartëson figurën e Heroit të Popullit, Petrit Dume dhe të drejtuesve të tjerë të kësaj lufte në Kolonjë, ndëshkohet me pretekstin se ka lexuar një libër me kritika letrare të prof. dr. Rexhep Qoses dhe pas një sërë masash, çohet me një detyrë të ulët, në një repart të largët, ku qëndron i harruar për rreth njëzet vjet. Me formimin i tij intelektual, edukatën e marrë në familje dhe përkushtimin në detyrë, ai dallohet për rezultate shumë të larta. Të gjithë që e njohën apo punuan me të, e kujtojnë si një kuadër të talentuar, të kulturuar, të guximshëm, të ndershmë dhe me shpirt krijues, që e donte ushtrinë me gjithë zemër. Ai gëzonte respektin e



veçantë të shokëve dhe vartësve të tij, oficerë dhe ushtarë. Ndërkohë, kryen studimet në Universitetin shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Politike - Juridike dhe studion me pasion, jo vetëm artin ushtarak, por edhe në fushën e letërsisë, artit, historisë etj.

Me gjithë vështirësitë e njohura, ai është nga të parët kuadro të ushtrisë që mbështeti me entuziazëm proceset demokratike në vend, duke predikuar gjithmonë mirëkuptim mes vëllezërve të një gjaku.

Duke parë aftësitë e spikatura të tij, pas përmbyesjes së diktaturës, i jepet grada nënkolonel dhe emërohet shef i Mbrojtjes Civile të rrethit të Durrësit.

Pas largimit nga ushtria, caktohet në detyrën e shefit të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore në Këshillin e Rrethit. Bëhet promotor i organizimit dhe zhvillimit të dhjetëra e dhjetëra veprimtarive, kush-tuar figurave të shquara, të goditura dhe lënë qëllimisht në hije apo të promovimit të krijimtarisë letrare të autorëve të ndryshëm, sidomos durrsakë. Puna e tij në këtë drejtim është krahasuar me atë të një institucioni të tërë. Këto veprimtari kanë qenë përherë mbresëlënëse dhe janë pasqyruar gjerësisht në të gjitha stacionet televizive, në radio apo gazeta të ndryshme.

Mbas suprimimit të seksionit që drejtonte, duke qenë jurist, fillon punë

në Gjykatën e Rrethit, ku qëndron për shtatë vjet dhe prej dymbëdhjetë vjetësh, kryen detyrën e Përmbaruesit gjyqësor, gjersa doli në pension.

Nuk ka reshtur së kryeri dhe detyrat shoqërore, si anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, nënkryetar i Shoqatës kombëtare "Skënderbegasi", kryetar i degës së kësaj shoqate në Durrës, anëtar i Kryesisë së shoqatës të miqësisë Shqipëri - Rusi, nënkryetar i degës së SHKUR - it, sekretar i shoqatës së Intelektualëve në Durrës etj. Tani është zgjedhur kryetar i Bordit drejtues të teatrit "A. Moisiu". Pas viteve nëntëdhjetë, fillon të shkruajë dhe botojë krijimtari të mirëfilltë letrare, thajse të të gjitha zhanreve të letërsisë, si poezi, tregime, novela, romane, publicistikë, kritikë letrare etj. Dyzet libra dhe qindra e qindra artikuj të shkruar e botuar nga ai, në shtypin e kohës, gjë që e bën të njohur kudo. Shumë nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, janë botuar jashtë shtetit dhe janë vlerësuar shumë nga kritika e specializuar dhe lexuesit. Për të dhe krijimtarinë e tij, janë botuar librat voluminozë "Të shkruash në liri - Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu" (2009), dhe "Liria e të shkruarit" (2014).

Është redaktor i shumë librave dhe përpilues i parathëniesve të tyre.

Ai është vlerësuar shumë lart për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga penat tona më të njohura. Në një nga librat e fundit, "Ishte koha kur...",

kritiku Kostaq Xoxa, duke folur për të shkruan: "Autori i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pas diktaturës, Shpendi Topollaj, të befason me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezitë, në tregimet, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin e thesareve të lashtësisë dhe veçanërisht të mitologjisë greke; në reportazhin artistik, në pasqyrimin dhe portretizimin e figurave të nëpërkëmbura nga një sistem totalitar gjysmëshekullor...". Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

* * *

Poezi nga Shpend Topollaj për Shkollën Ushtarake "Skënderbej"

MALL QË S`SHUHET KURRË
Më mundon një brengë e vjetër,
Shumë motive për të gjej;
Dua që të hedh në letër,
Mall për shkollën "Skënderbej".

Sa herë shkruaj, prap' e gris,
Nuk zbraz dot gjiri ç'më mban,
I ka rrënjët si një lis,
Është i gjerë pa fund e anë.

E të lapsin e mendohem,
Nga t'ia nis, oh! qenka hall,
Por e shoh që kot mundohem,
Nuk u ndaka dot ky mall.

Ato vite do t'i ruaj
Gjat' në mend e thell' në zemër,
Skënderbegasi të më quaj,
Kush për mua do një emër.

Kujtim Boriçi, Maksim Fejzullai



SHOQATA E USHTARAKËVE "SKËNDERBEJ USA" NY-NJ

Përtej oqeanit me zemër në atdhe

Si të gjithë ushtarakët shqiptarë (në pension e të liruar), familjarë dhe miq të tyre me banim në New York dhe New Jersey, i janë bashkuar mjedisit festiv të Nëntorit, në Tiranë dhe në Prishtinë, në Vlorë dhe në Shkup, në Europë e kudo në botë, ku jetojnë e punojnë shqiptarë.

Në një festë të bukur familjare e shoqërore, nën tingujt e orkestrës së këngëtarit Muharrem Borova e miqve të tij, zv. presidentja e Shoqatës, znj. Nadire Xhakolli, pasi ftoi pjesëmarrësit të nderojnë Himnin e Flamurit dhe Himnin e ShBA-ve, njoftoi për rezultatet e zgjedhjeve të reja për Kryesinë e Shoqatës.

Tashmë President Nderi i Shoqatës, kapiten i Rangut të Parë (P), z. Bujar Hasani uroi për detyrën e re dhe ftoi të mbajë fjalën përshëndetëse presidentin e sapo zgjedhur, kolonelin (L) prof. asoc. dr. Gëzim Mustafaj.

Profesor Mustafaj bëri një sintezë të rrugës dhe luftës së popullit shqiptar, duke evidentuar ngjarjet e mëdha të historisë sonë nga 28 nëntori i Skënderbeut e i Ismail Qemal Vlorës, fitoren mbi nazi-fashizmin në krah të Bllokut Antifashist, ndryshimet demokratike në Shqipëri e deri te fitorja e UÇK-së në aleancë me NATO-n mbi regjimin gjakatar serb dhe krijimin e shtetit të dytë shqiptar, Republikës së Kosovës. Ai përmendi faktin që 110-vjetori i pavarësisë i prin 110-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare.

Dhe për gëzimin tonë, këto festa përkojnë edhe me 5-vjetorin e krijimit të Shoqatës sonë.

Me këtë rast u dhanë certifikata mirënjohjeje për veprimtarë të saj, dhe në një moment të bukur u soll një tortë për datëlindjen dhe daljen në pension

VERI TALUSHLLARI
Kapiten (P), NY, SHBA

të z. Agim Pira, një nga veprimtarët më aktivë të Shoqatës dhe punës në komunitet.

Për lexuesin e gazetës "Ushtria", "Association of SKËNDERBEJ USA", në Nju Jork, ka në radhët e saj ushtarakë shqiptarë, në pension ose në lirim, me banim në Nju Jork dhe zonën verilindore të Nju Xhersi, familjarë të

tyre, miq e dashamirës. E krijuar më 10 dhjetor 2017 dhe e miratuar nga Departamenti i Shtetit të NY në shkurt 2019, Shoqata jonë ka një historik të pasur veprimtarish.

Ne festojmë madhërisht Pavarësinë e Shqipërisë dhe Fitoren mbi nazi-fashizmin, Ditën e Pavarësisë së SHBA-ve dhe përkujtojmë data e ngjarje

historike të Atdheut tonë. Duke pasur një anëtarësi me nivel të lartë shkollimi dhe intelektual, shoqata "SKËNDERBEJ USA" ka zhvilluar veprimtari shkencore e letrare, si Simpoziumi për 100-vjetorin e Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe Luftës së Vlorës, promovimin e librave me përmbajtje letrare apo studimore të botuar nga anëtarët e

Shoqatës, ka përkujtuar Dëshmorët e luftërave për liri e pavarësi, apo të rënë në krye të detyrës, viteve të fundit etj.

Në bashkëpunim me SHKURSH në Shqipëri, kemi kontribuar me shkrime apo financiarisht për botime librash dhe shfaqje dokumentarësh për historikun e Ushtrisë Shqiptare, që këtë vit shënon gjithashtu 110-vjetorin e krijimit, më 4 dhjetor. Ne kemi qenë pjesëtarë aktivë me shkrime në serinë "Skënderbegasit në vite" të Kujtim Boriçit e Maksim Fejzullait dhe atë për Oficeret Shqiptare, Dokumentarin kushtuar kursit të parë të vajzave oficere etj.

Disa herë ne kemi pasur mik në festat dhe veprimtaritë tona z. Adrian Bali, ish-Atashë Ushtarak i RSH në Uashington.

Një bashkëpunim të mirë kemi me Shoqatën Atdhetare "Bijtë e Shqipes" në Filadelfia dhe Forumin Ushtarak të saj.

Kështu, në 5-vjetorin e krijimit të saj, shoqata "SKËNDERBEJ USA" NY, vjen me një bilanc të pasur veprimtarish, çka e bën të ligjshëm gëzimin dhe harenë në këtë festë të bukur të 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Aktualisht, Shoqata është në një proces riorganizimi të degëve të saj me synimin për zgjerimin e radhëve dhe anëtarësimin e sa më shumë kolegëve tanë.

Dhe me urimin për më shumë veprimtari të pasura e të larmishme, festuesit shpërndahen në të pestë lagjet e Nju Jorkut dhe në Nju Xhersi, për t'u takuar, siç thuhet në moton e Shoqatës "Së bashku për punë të mira!".

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

MbrojtjaViti i 90-të i botimit
SPECIALE